




REPUBLIKA E KOSOVËS-REPUBLIKA KOSOVA  
KOMUNA E OBILIQIT-OPŠTINA OBILIĆ  
DREJTORIA E ADMINISTRATËS PËRGJITHSHME  
UPRAVA OPŠTE ADMINISTRACIJE



Dalës-Izlazna

Nr. -1-85

Data 30.06.2023

Br.

Datum

OBILIĆ

REPUBLIKA E KOSOVËS  
REPUBLIKA KOSOVA - REPUBLIC OF KOSOVO  
KOMUNA E OBILIQIT  
OPŠTINA OBILIĆ - MUNICIPALITY OF OBILIC



### KUVENDI KOMUNAL OBILIQ

Skupština Opštine Obilić - Municipality Assembly Obiliq

Në mbështetje të nenit 12.2, pika c) të Ligjit për Vetëqeverisjen Lokale nr.03/L-040, (Gazeta Zyrtare nr.28 të dt.04.06.2008), nenit 44.1 dhe 47.3, të Statutit të Komunës nr.-I-34, të dt.25.04.2016, të Kreut II dhe Kreut III të Ligjit Nr.03/L-049, për Financat e Pushtetit Lokal (Gazeta zyrtare e Republikës së Kosovës Nr.27/2008, 03 Qershor 2008) i plotësuar dhe ndryshuar me Ligjin Nr.05/L-108 (Gazeta zyrtare e Republikës së Kosovës Nr.28/2016, 03 Gusht 2018) si dhe nenit 39 të Rregullores së punës së Kuvendit, Kuvendi komunal pas shqyrtimit të kërkesës nga DEFZH-ja, nr.- IV-438, të dt.15.06.2023, në mbledhjen e mbajtur me dt. 30.06.2023, mori këtë:

## V E N D I M

1. Aprovohet plotësimi dhe ndryshimi i Rregullores për Tarifa Ngarkesa dhe Gjoha Komunale nr.05/2022, të dt.26.10.2022, sipas sugjerimit të Ministrisë së linjave.
2. Ky Vendim hyn në fuqi (15) pesëmbëdhjetë ditë pas regjistrimit në Zyrën e protokollit të MAPL-së, dhe shtatë (7) ditë pas publikimit në web faqen e Komunës .

-T'i dërgohet  
-Kryetarit  
-Nënkryetarit  
- Kryesueses  
- Anëtarëve të KK  
- DEFZH  
-MAPL  
-Arkivit



Kryesuese e Kuvendit Komunal

*Vlora Mjekiqi Kabashi*  
Vlora Mjekiqi Kabashi



REPUBLIKA E KOSOVËS - REPUBLIC OF KOSOVO  
KOMUNA E OBILIQIT - OPŠTINA OBILIC  
DREJTORIA E ADMINISTRATËS PËRGJITHSHME  
UPRAVA OPŠTE ADMINISTRACIJE



Dalës-Izlazni:

Nr. -1-85  
Br.

Data 30.06.2023  
Datum

OBILIQ OBILIC



**REPUBLIKA E KOSOVËS**  
REPUBLIKA KOSOVA - REPUBLIC OF KOSOVO  
**KOMUNA E OBILIQIT**  
OPŠTINA OBILIC - MUNICIPALITY OF OBILIC



**RREGULLORE (KO) NR. 05/2022 PËR TARIFA NGARKESA DHE GJOBA  
KOMUNALE NË KOMUNËN E OBILIQIT**

**OBILIQ, TETORË 2022**

Në mbështetje të nenit 11 dhe nenit 12, paragrafi 2, pika c), të Ligjit Nr. 03/L-040 për Vetëqeverisje Lokale (Gazeta Zyrtare e Republikës së Kosovës Nr. 28/2008, 04 Qershor 2008), të Kreut II dhe Kreut III të Ligjit Nr. 03/L-049 për Financat e Pushtetit Lokal (Gazeta Zyrtare e Republikës së Kosovës Nr. 27/2008, 03 Qershor 2008), i plotësuar dhe ndryshuar me Ligjin Nr. 05/L-108 (Gazeta Zyrtare e Republikës së Kosovës, Nr. 28/2016, 03 Gusht 2018), të nenit 22 dhe nenit 23 të Ligjit Nr. 04/L-110 për Ndërtim (Gazeta Zyrtare e Republikës së Kosovës, Nr. 18/2012, 03 korrik 2012), të nenit 7, paragrafi 1 dhe 2, të Ligjit Nr. 05/L-087 për Kundërvajtje (Gazeta Zyrtare e Republikës së Kosovës, Nr.33/2016, 08 shtator 2016), të nenit 38.pika 1/3 neni 83 pika 7.dhe neni 89. të Statutit të Komunës), të Statutit të Komunës së Obiliqit , (Gazeta Zyrtare e Republikës së Kosovës Nr. -1-34/2016 të datës.25.04.2016, në mbledhjen e mbajtur më datën 26.10.2022 miratoi:

## **RREGULLORE (KO) NR. 05/2022 PËR TARIFA NGARKESA DHE GJOBA KOMUNALE NË KOMUNËN E OBILIQIT**

### **KAPITULLI I DISPOZITAT E PËRGJITHSHME**

#### **Neni 1 Qëllimi**

Kjo Rregullore ka për qëllim përcaktimin e aktiviteteve të cilat i nënshtrohen taksës komunale në Komunën e Obiliq-it lartësinë e taksave komunale, përcaktimin e kategorive të liruar nga kjo taksë dhe përcaktimin e kundërvajtjeve dhe sanksioneve kundërvajtësit për shkeljet e dispozitave të kësaj Rregulloreje.

#### **Neni 2 Fushëveprimi**

Dispozitat e kësaj Rregulloreje janë të obligueshme për të gjithë personat fizik dhe juridik që nëpërmjet ndonjë aktiviteti të zhvilluar obligohen të paguajnë taksë komunale të përcaktuar me këtë Rregullore si dhe për të gjitha njësitë e Komunës që zbatojnë dispozitat e kësaj Rregulloreje.

#### **Neni 3 Përkufizimet**

1. Shprehjet e përdoruar në këtë Rregullore kanë këto kuptime:

1.1. **Takës komunale** – nënkupton shumën fikse dhe e pakthyeshme e pagesës sipas dispozitave të kësaj Rregulloreje, që paguhet nga personat juridik dhe fizik autoriteteve të Komunës në mënyrën e paraparë në këtë Rregullore, në emër të:

- 1.1.1. lëshimit të certifikatave dhe dokumenteve tjera zyrtare të lëshuara nga Komuna;
  - 1.1.2. shërbimeve administrative të pranuar nga Komuna;
  - 1.1.3. ushtrimit të veprimtarisë afariste në territorin e Komunës;
  - 1.1.4. pronësisë së mjeteve motorike në territorin e Komunës;
  - 1.1.5. ndërtimit, rrënimit të objekteve dhe ndërhyrjeve në infrastrukturë komunale në territorin e Komunës; dhe
  - 1.1.6. shfrytëzimit të objekteve, hapësirës apo të mirave tjera publike në territorin e Komunës.
- 1.2. **Taksa qendrore** – nënkupton taksat që përcaktohen nga Qeveria e Republikës së Kosovës, të cilat mbliidhen nga Komuna;
- 1.3. **Vit fiskal** - nënkupton periudhën nga data një (1) janar deri më datën tridhjetenjë (31) dhjetorë të njëjtit vit;
- 1.4. **Gjobë** – nënkupton sanksionin kundërvajtës që i shqiptohet personave juridik dhe fizik për shkelje të dispozitave të kësaj Rregulloreje.
- 1.5. **Persona paraplegjik** – nënkupton personat të cilët si shkak i sëmundjes apo dëmtimit të sistemit nervor qendror apo periferik kanë humbur në formë të përhershme mundësinë e zhvendosjes dhe lëvizjes së ekstremiteteve të poshtme;
- 1.6. **Persona tetraplegjik** – nënkupton personat të cilët si shkak i sëmundjes apo dëmtimit të sistemit nervor qendror apo periferik kanë humbur në formë të përhershme mundësinë e zhvendosjes dhe lëvizjes të ekstremiteteve të sipërme dhe të poshtme.
- 1.7. **Person** – nënkupton personin fizik dhe juridik;
- 1.8. **Person fizik** – nënkupton personin fizik jo afarist që nuk ka të regjistruar aktivitet biznesi; dhe personi fizik afarist që ka të regjistruar biznes në bazë të legjislacionit në fuqi dhe që zhvillon aktivitet të rregullt afarist;
- 1.9. **Person juridik** – nënkupton një shoqëri ose një organizatë tjetër biznesi që ka statusin e një personi juridik sipas legjislacionit në fuqi për shoqëritë tregtare dhe çdo legjislacion tjetër të aplikueshëm në Kosovë;
- 1.10. **Pano reklamuese** – nënkupton tabelën apo shenjën reklamuese me qëllim të reklamimit të mallrave apo shërbimeve, i vendosur në një objekt statik apo lëvizës; dhe
- 1.11. **Shoqëri Tregtare** – nënkupton termin e përgjithshëm që përfshin çfarëdo lloji të shoqërisë tregtare të themeluar në Kosovë sipas Ligjit për Shoqëritë Tregtare apo ndonjë ligji tjetër, duke përfshirë bizneset individuale, ortakëritë e përgjithshme, ortakëritë e kufizuara, shoqëritë me përgjegjësi të kufizuar dhe shoqëritë aksionare.

## **KAPITULLI II**

### **KORNIZAT E PËRGJITHSHME TË TAKSAVE KOMUNALE**

#### **Neni 4**

##### **Parimet e përgjithshme të taksave komunale në Komunë**

1. Të gjitha taksat komunale përcaktohen me këtë Rregullore dhe me ndonjë Rregullore tjetër komunale.
2. Të gjitha taksat komunale përcaktohen marrë parasysh parimin e jo diskriminimit dhe të proporcionalitetit, sipas dispozitave ligjore në fuqi.
3. Taksat komunale që rezultojnë si pasojë ndonjë veprimi apo shërbimi të kryer nga organet e Komunës, bazohen në koston e atij veprimi që i është shkaktuar Komunës.
4. Asnjë taksë komunale që nuk është e përcaktuar me këtë Rregullore apo në ndonjë Rregullore tjetër komunale nuk mund të kërkohet që të paguhet.

#### **Neni 5**

##### **Pagesa e taksave komunale**

1. Të gjitha pagesat e taksave komunale që duhet të kryhen sipas dispozitave të kësaj Rregulloreje, bëhen sipas shumave të përcaktuara në këtë Rregullore dhe paguhen në valutën euro (€).
2. Të gjitha pagesat mbi dhjetë (10 €) euro sipas kësaj Rregulloreje bëhen nëpërmjet bankave apo institucioneve financiare të licencuara, nëpërmjet një urdhërpagese të pranuar nga zyrtari përkatës komunal, në xhirollogarinë e Komunës të përcaktuar vendimin e Kryetarit të Komunës.
3. Të gjitha pagesat deri në dhjetë (10 €) euro sipas kësaj Rregulloreje bëhen pranë institucioneve përkatëse komunale.
4. Për pagesat e realizuara sipas paragrafit tre (3) të këtij neni, Komuna lëshon vërtetim përkatës.
5. Të gjitha pagesat e realizuara sipas paragrafit tre (3) të këtij neni dhe pagesat e bëra nëpërmjet kioskave elektronike (e-kioskë), i dorëzohen arkës kryesore të komunës në ditën e fundit të punës brenda javës, nga ora katërbëdhjetë (14:00) deri në ora gjashtëmbëdhjetë (16:00).
6. Të gjitha mjetet e pranuar në arkën kryesore të komunës sipas paragrafit 5 të këtij neni, deponohen në xhirollogarinë e Komunës brenda tri (3) ditëve të punës të javës pasuesi.

**Neni 6**  
**Lirimet nga taksat komunale**

1. Të gjitha kategoritë e liruara nga pagesa e taksave komunale sipas dispozitave të kësaj Rregulloreje, përcaktohen me këtë Rregullore.
2. Për çdo lloj lirimi nga taksat komunale të përcaktuara me këtë Rregullore, personat që përfitojnë nga ky lirim ofrojnë dokumentacionin përkatës që dëshmon përkatësinë e tyre për të përfituar nga lirimet.
3. Për çdo lloj lirimi nga taksat komunale të përcaktuara me këtë Rregullore zyrtari përgjegjës i Komunës ia bashkëngjit lëndës shkresën me bazën ligjore për lirim nga pagesa.
4. Nëse ndonjë procedura ku kërkohet pagesa e taksave komunale është filluar me kërkesë të më shumë se një personi, ku jo të gjithë janë të liruar nga pagesa e taksave komunale, atëherë taksa komunale paguhet nga ai person i cili nuk është i liruar nga pagesa.

**KAPITULLI III**  
**TAKSA KOMUNALE PËR LËSHIMIN E CERTIFIKATAVE DHE DOKUMENTEVE**  
**ZYRTARE**

**Neni 7**

**Lartësia dhe pagesa e taksës për lëshimin e certifikatave dhe dokumenteve zyrtare**

1. Të gjithë personat që pajisen me certifikata zyrtare dhe dokumente tjera zyrtare nga Komuna, paguajnë taksë komunale, si në vijim:
  - 1.1. Certifikata e lindjes – një euro (1 €);
  - 1.2. Ekstrakti i lindjes - një euro (1 €);
  - 1.3. Certifikata e shtetësisë - një euro (1 €);
  - 1.4. Certifikata e martesës - një (euro 1 €);
  - 1.5. Certifikata e vendbanimit apo e vendqëndrimit - një euro (1 €);
  - 1.6. Certifikata e gjendjes martesore - një euro (1 €);
  - 1.7. Certifikata e vdekjes - një euro (1 €);
  - 1.8. Certifikata e bashkësisë familjare - një euro (1 €);
  - 1.9. Akti i vdekjes - një euro (1 €);
  - 1.10. Vërtetim për afërsinë familjare - një euro (1 €);
  - 1.11. Vërtetim mbi mjetet e jetesës - një euro (1 €);
  - 1.12. Vërtetim mbi mbajtjen e prindërve - një euro (1 €);
  - 1.13. Vërtetim mbi marrëdhëniet familjare - një euro (1 €);
  - 1.14. Vërtetim që personi është në jetë - një euro (1 €);
  - 1.15. Vërtetim që personi nuk është banor i komunës - një euro (1 €);
  - 1.16. Vërtetimi mbi konfirmimin e identitetit - një euro (1 €);
  - 1.17. Vërtetim për lajmërim apo ç 'lajmërimin e vendbanimit - një euro (1 €);
  - 1.18. Vërtetimi që personi nuk është regjistruar në regjistrat civil - një euro (1 €);
  - 1.19. Vërtetimi që personi nuk është në marrëdhënie pune - një euro (1 €);

- 1.20. Vërtetim për gjendjen ekonomike - një euro (1 €); dhe
  - 1.21. Kopja e certifikatave dhe vërtetimeve të lëshuara më parë – pesëdhjetë cent(0.50€);
  - 1.22. Procedurat për trashëgimi-pesë euro (5.00 €)
  - 1.23. Dhënja e çdo lloji të Certifikatës në bazë të dy dëshmitarëve – dy euro (2.00€)
  - 1.24. Vërtetim për qëndrim të përkohshëm në Kosovë –pesë euro (5.00€)
  - 1.25. Certifikata mbi gjendjen ekonomike apo deklaratat apo vërtetimet tjera –tri euro (3.00€)
  - 1.26. Ndririmi i emrit personal –njëzet euro (20. 00€)
  - 1.27. Regjistrimet nga bota e jashtme – pesë euro (5.00€)
  - 1.28. Regjistrimet e mëvonëshme përmes bordit -pesë euro (5.00 €)
2. Paguesa sipas paragrafit 1 të këtij neni bëhet para pranimit të certifikatës apo dokumenteve zyrtare. Pa dëshmi të pagesës nuk mund të dorëzohet kërkesa apo të merret certifikata apo dokumenti zyrtar.
  3. Për pagesat e bëra sipas paragrafit 1 të këtij neni Komuna lëshon vërtetimin përkatës dhe ky vërtetim është i vlefshëm brenda gjithë vitit fiskal, në rast se kërkesa për marrje të certifikatave dhe dokumenteve zyrtare nuk mund të dorëzohet pas pagesë së taksës.

### **Neni 8**

#### **Lirimet nga pagesa e taksës për lëshimin e certifikatave dhe dokumenteve zyrtare**

1. Nga pagesa e taksës për lëshimin e certifikatave dhe dokumenteve zyrtare janë të liruara kategoritë si në vijim:
  - 1.1. Veteranët e luftës;
  - 1.2. Invalidët e luftës së UÇK-së dhe familjarët e dëshmorëve dhe të zhdukurve të UÇK-së;
  - 1.3. Personat e verbër;
  - 1.4. Personat paralogji dhe tetraplegji k; dhe
  - 1.5. Përfituesit e skemave social

### **Neni 9**

#### **Detyrimi lidhur me të dhënat**

1. Të gjithë personat që kërkojnë të pajisen certifikatat e paraparë nga nën paragrafi 1.1 deri te nën paragrafi 1.8 të paragrafit 1 të nenit 8 të kësaj Rregulloreje, duhet të ofrojnë të dhënat lidhur me regjistrin civil me kohë dhe t'i përditësojnë ato brenda afatit të përcaktuar ligjor.
2. Të gjitha personat që kërkojnë të pajisen me vërtetimet e parapara nga nën paragrafi 1.9 deri te nën paragrafi 1.28 të nenit 8 të kësaj Rregulloreje, duhet të ofrojnë informata të sakta lidhur me gjendjen përkatëse për të cilën pajisen me vërtetim.

**KAPITULLI IV**  
**TAKSAT KOMUNALE ADMINISTRATIVE**

**Neni 10**

**Lartësia dhe pagesa e taksave komunale administrative**

1. Të gjithë personat që pranojnë shërbime të caktuara komunale nga Komuna të paraparë në këtë nen, paguajnë taksë komunale administrative, si në vijim:

- 1.0 Kurorëzimi brenda objektit të komunës, brenda orarit të punës–dhjetë euro(10€);
  - 1.1. Kurorëzimi brenda objektit të komunës, jashtë orarit të punës – njëzetë euro (20 €);
  - 1.2. Kurorëzimi jashtë objektit të komunës, brenda orarit të punës –pesëdhjetë euro(50 €);
  - 1.3. Kurorëzimi jashtë objektit të komunës, jashtë orarit të punës – njëqindë euro (100 €);
  - 1.4. Korrigjimi emrit personal (gurëzimi) – tri euro (3 €);
  - 1.5. Korrigjimi i emrit personal – pesë euro (5.00 €);
  - 1.6. Ndërrimi i mbiemrit pas anulimit të martesës pesë euro (5 €);
  - 1.7. Ndrimi i emrit personal –njëzet euro (20.00€)
  - 1.8. Anulimi i dyfishtë i regjistrimit në gjendjen civile pesë euro (5 €);
  - 1.9. Konfirmimi i deklaratës me dy dëshmitar- dy euro (2 €);
  - 1.10. Kërkesa për procesverbal të ndryshme - pesë euro (5 €);
  - 1.11. Pajisja me dokumente nga arkiva (për një faqe) – njëzetë cent (0.20€);
  - 1.12. Lëshimi i vërtetimit për gjendjen e tatimit në pronë – një euro (1.00.€)euro
  - 1.13. Konfirmimi i vërtetësisë së nënshkrimit – një euro (1 €);
  - 1.14. Konfirmimi i vërtetësisë së fotokopjes (për një faqe A4)– pesëmbëdhjetë cen(0.15.€);
  - 1.15. Konfirmimi i vërtetësisë së fotokopjes (për një faqe A3) – njëzetepesë cent (0.25 €);
  - 1.16. Leja mbi varrimin – tri euro (3.00 €);
  - 1.17. Inspektime të ndryshme me kërkesën të personave fizik – dhjetë euro (10.00 €);
  - 1.18. Inspektime të ndryshme me kërkesë të personave juridik – pesëmbëdhjetë euro (15.00 €);
  - 1.19. Asgjësim mallrash : me kërkesë dhe specifikacion për largim të mallit të prishur ushqimor me afat të skaduar gjashtëdhjetë euro (60.00) € ndërsa me kërkesë dhe specifikacion për mallin e prishur me defekte jo ushqimore tridhjetë euro (30.00€);
  - 1.20. Lëshimi i certifikatës së përdorimit – njëzetë euro (20.00 €);
  - 1.21. Lëshimi i pëlqimit urbanistik dhe dokumenteve tjera urbanistike – dhjetë euro 10.00€);
  - 1.22. Lëshimit të pëlqimeve dhe dokumenteve tjera në fushën emergjencës – pesëdhjetëeuro (15.00 €);
  - 1.23. Lëshimi i pëlqimeve dhe dokumenteve tjera në fushën e higjienës dhe sanitarisë pesëdhjetë euro (15.00 €).
  - 1.24. Lëshimi i pëlqimeve dhe dokumenteve tjera në fushën e tregtisë – pesëmbëdhjetë euro (15.00 €).
2. Pagesa sipas paragrafit 1 të këtij neni bëhet para pranimit të shërbimit komunal dhe pa dëshmi të pagesës nuk ofrohet shërbimi.

## Neni 11

### Lirimet nga pagesa e taksave komunale administrative

1. Nga pagesat e taksës komunale administrative janë të liruar kategoritë si në vijim:
  - 1.1. Veteranët e luftës;
  - 1.2. Invalidët e luftës së UÇK-së dhe familjarët e dëshmorëve dhe të zhdukurve të UÇK-së; dhe
  - 1.3. Personat e verbër;

## KAPITULLI V

### TAKSA KOMUNA PËR USHTRIMIN E VEPRIMTARISË AFARISTE

## Neni 12

### Lartësia dhe pagesa e taksës komunale për ushtrimin e veprimtarisë afariste

1. Çdo shoqëri tregtare e regjistruar në Agjencinë për Regjistrimin e Bizneseve të Kosovës (ARBK) që ndodhet brenda Komunës, paguan taksë vjetore komunale në emër të ushtrimit të veprimtarisë afariste profesionale, për aktivitet ekonomike të zhvilluar si në vijim:

- 1.1. Kultivimi i drithërave (përveç orizit), të korrave bishtajore dhe farërave vajore-pesëdhjetë euro (50 €);
- 1.2. Kultivimi i orizit – pesëdhjetë euro (50 €);
- 1.3. Kultivimi i pjeprave, rrënjëve, dhe i zhardhokëve – pesëdhjetë euro (50 €);
- 1.4. Kultivimi i duhanit – pesëdhjetë euro (50 €);
- 1.5. Kultivimi i të mbjell urave fibër – pesëdhjetë euro (50 €);
- 1.6. Kultivimi i të mbjell urave tjera njëvjeçare – pesëdhjetë euro (50 €);
- 1.7. Kultivimi i rrushit – pesëdhjetë euro (50 €);
- 1.8. Kultivimi i frutave tropikale dhe subtropikale – pesëdhjetë euro (50 €);
- 1.9. Kultivimi i frutave agrume – pesëdhjetë euro (50 €);
- 1.10. Kultivimi i pemëve me fruta me bërthamë dhe lëvozhgë – pesëdhjetë euro (50 €);
- 1.11. Kultivimi i frutave tjera pemore dhe i shkurreve dhe arrave – pesëdhjetë euro (50 €);
- 1.12. Kultivimi i frutave vajore – dyzet euro (40 €);
- 1.13. Kultivimi i të korrave për pije – dyzet euro (40 €);
- 1.14. Kultivimi i erëzave aromatikeve, i të korrave për ilaçe dhe farmaci dyzet euro(40€);
- 1.15. Kultivimi i të korrave tjera shumëvjeçare – dyzet euro (40 €);
- 1.16. Shumimi i bimës – dyzet euro (40 €);
- 1.17. Kultivimi i bagëtisë djathore/qumështore – pesëdhjetë euro (50 €);
- 1.18. Kultivimi i bagëtive tjera dhe buallicave – pesëdhjetë euro (50 €);
- 1.19. Kultivimi i kuajve dhe llojeve tjera të kuajve – pesëdhjetë euro (50 €);
- 1.20. Kultivimi i deveve dhe llojeve të tyre – pesëdhjetë euro (50 €);
- 1.21. Kultivimi i dhënëve dhe dhive – pesëdhjetë euro (50 €);
- 1.22. Kultivimi i derrave/thive – pesëdhjetë euro (50 €);
- 1.23. Kultivimi i shpezëve – pesëdhjetë euro (50 €);
- 1.24. Kultivimi i kafshëve tjera – pesëdhjetë euro (50 €);

- 1.25. Blegtoria e përzier – pesëdhjetë euro (50 €);
- 1.26. Aktivitetet përkrahëse për prodhimin e të korrave – dyzet euro (40 €);
- 1.27. Aktivitetet përkrahëse për prodhimin e kafshëve pesëdhjetë euro (50 €);
- 1.28. Gjuetia, vënia e pusive dhe aktivitetet tjera shërbyese – tridhjetë euro (30 €);
- 1.29. Kultura pyjore dhe aktivitetet tjera të pylltarisë – tridhjetë euro (30 €);
- 1.30. Prerja e drunjëve-trungjeve – tridhjetë euro (30 €);
- 1.31. Grumbullimi i produkteve të egra të rritura në pyll dhe jashtë pyllit–tridhjetë euro (30 €);
- 1.32. Shërbimet përkrahëse për pylltarinë – tridhjetë euro (30 €);
- 1.33. Peshkimi detar – pesëdhjetë euro (50 €);
- 1.34. Peshkimi i ujërave të ëmbla – pesëdhjetë euro (50 €);
- 1.35. Akua kultura detare – pesëdhjetë euro (50 €);
- 1.36. Akuakultura e ujërave të ëmbla – pesëdhjetë euro (50 €);
- 1.37. Xehërorja antracitit – dymijë euro (2,000 €);
- 1.38. Xehërorja linjtit – njëzete mijë euro (20,000 €);
- 1.39. Nxirrja e naftës së papërpunuar – dymijë euro (2,000€);
- 1.40. Miniera e xehes së hekurit – dymijë euro (2,000 €);
- 1.41. Miniera e uraniumit dhe xehes së toriumit – dymijë euro (2,000 €);
- 1.42. Miniera e metaleve tjera me ngjyrë – dhjetëmijë euro (10,000 €);
- 1.43. Gur-thyerja e gurit ornamental dhe ndërtimor, gëlqeres, gipsit, shkumësit dhe rrasave dymijë euro (2,000 €);
- 1.44. Operimi i puseve të zhavorrit dhe rërës; miniera e argjilave dhe kaolinit – Njëmijë euro (1,000€);
- 1.45. Miniera e mineraleve kimikale dhe plehëruese – dhjetëmijë euro (10,000 €);
- 1.46. Nxjerrja e torfës – pesëqindtë euro (500 €);
- 1.47. Minierat dhe gurëthyesit tjerë p.k.t. – dymijë euro (2,000€);
- 1.48. Aktivitetet përkrahëse për nxjerrjen e naftës dhe gazit natyror dymijë euro (2,000.€);
- 1.49. Aktivitetet përkrahëse për minierat dhe gurëthyesit tjerë - njëmijë euro (1,000. €);
- 1.50. Procesimi dhe konservimi i mishit – pesëqindtë euro (500 €);
- 1.51. Procesimi dhe konservimi i mishit të shpezëve – pesëqindtë euro (500 €);
- 1.52. Prodhimi i mishit dhe i produkteve të mishit të shpezëve – pesëqind euro (500 €);
- 1.53. Procesimi dhe konservimi i peshqve, kurstaceve dhe moluskëve pesëqind euro (500 €);
- 1.54. Procesimi dhe konservimi i patateve – katërqindë euro (400 €);
- 1.55. Prodhimi i lëngjeve të frutave dhe perimeve – katërqindë euro (400 €);
- 1.56. Procesimi dhe konservime tjera të frutave dhe perimeve – katërqindë euro (400 €);
- 1.57. Prodhimi i vajrave dhe yndyrave – pesëqindë euro (500 €)
- 1.58. Prodhimi i gjalpës dhe yndyrave të ngjashme ushqimore – katërqindë euro (400 €);
- 1.59. Operimi i përgatitjes së prodhimeve qumështore dhe djathit - treqindë euro (300 €);
- 1.60. Prodhimi i akullores – treqindë euro (300 €)
- 1.61. Prodhimi i produkteve të miellit të drithit – katërqindë euro (400 €);
- 1.62. Prodhimi i niseshteve dhe i produkteve të saja – katërqindë euro (400 €);
- 1.63. Prodhimi i bukës, i simiteve dhe ëmbëlsirave të freskëta–njëqindë euro (100 €);
- 1.64. Prodhimi i biskotave dhe galetave ëmbëlsirave me afat të gjatë – katërqindë euro (400 €);
- 1.65. Prodhimi i makaronave, petave, kuskove dhe produkteve të ngjashme nga mielli

- katërqindë euro (400 €);
- 1.66. Prodhimi i sheqerit – pesëqindë euro (500 €);
  - 1.67. Prodhimi i kakaos, çokollatës dhe të ëmbëlsirave – katërqindë euro (400 €);
  - 1.68. Procesimi i çajit dhe i kafes – pesëqindë euro (500 €);
  - 1.69. Prodhimi i erëzave dhe salcave – katërqindë euro (400 €);
  - 1.70. Prodhimi i ushqimeve dhe gjellërave të gatshme katërqindë euro (400 €);
  - 1.71. Prodhimi i produkteve të homogjenizuara ushqimore dhe të ushqimore treqindë euro (300 €);
  - 1.72. Prodhimi i produkteve tjera ushqimore p.k.t. – treqindë euro (300 €);
  - 1.73. Prodhimi i ushqimeve të përgatitura për kafshët e fermës – njëqindë euro (100 €);
  - 1.74. Prodhimi i ushqimeve të përgatitura për kafshët përkëdhelëse -treqindë euro (300 €);
  - 1.75. Distilimi, riciklimi dhe përzierja e alkooleve – treqindë euro (300 €);
  - 1.76. Prodhimi i verës nga rrushi – katërqindë euro (400 €);
  - 1.77. Prodhimi i verës së mollës dhe verërave nga frutat tjera – katërqindë euro (400€);
  - 1.78. Prodhimi i pijeve të tjera të fermentuara jo të destiluara – treqindë euro (300€);
  - 1.79. Prodhimi i birrës – pesëqindë euro (500 €) Prodhimi i pijeve freskuese; prodhimi i ujit mineral dhe ujit në shishe katërqindëqindë euro (400 €)
  - 1.80. Prodhimi i produkteve të duhanit – katërqindë euro (500 €)
  - 1.81. Përgatitja dhe thurja e fijeve të tekstilit - katërqindë euro (400 €);
  - 1.82. Endja e tekstileve - treqindë euro (300 €);
  - 1.84 Finalizimi i tekstileve - dyqindë euro (200 €);
  - 1.85. Prodhimi i pëlhurave të thurura dhe të endura - treqindë euro (300 €);
  - 1.86. Prodhimi i artikujve të tekstilit të konfeksionuar përveç veshjes -dyqindë euro (200€);
  - 1.87. Prodhimi i qilimave dhe sexhadeve - dyqindë euro (200 €);
  - 1.88. Prodhimi i litarëve, kablove, spangove, rrjetave - dyqindë euro (200 €);
  - 1.89. Prodhimi i pëlhurave e artikujve pa endje, përveç artikujve të veshjes-dyqindë euro (200 €);
  - 1.90. Prodhimi i tekstileve tjerë teknik dhe industrial - treqindë euro (300 €);
  - 1.91. Prodhimi i produkteve të tjera tekstileve p.k.t. - treqindë euro (300 €);
  - 1.92. Prodhimi i veshjeve të lëkurës – katërqindë euro (400 €);
  - 1.93. Prodhimi i veshjeve të punës - dyqindë euro (200 €);
  - 1.94. Prodhimi i veshjeve të jashtme - treqindë euro (300 €);
  - 1.95. Prodhimi i veshjeve të brendshme - dyqindë euro (200 €);
  - 1.96. Prodhimi i veshjeve tjera - dyqindë euro (200 €);
  - 1.97. Prodhimi i artikujve nga gëzofi – dyqindë euro (200)
  - 1.98. Prodhimi i çorapeve të thurura - dyqindë euro (200 €);
  - 1.99. Prodhimi i rrobave të thurura dhe të thurura me grep - dyqindë euro (200 €);
  - 1.100. Ngjyrosja dhe veshja e lëkurës; veshja dhe ngjyrosja e gëzofit -dyqindë euro (200 €);
  - 1.101. Prodhimi i valixheve, çantave dhe ngjashëm, takëmeve të kuajve dhe parzmoreve - treqindë euro (300 €);
  - 1.102. Prodhimi i këpucëve dhe mbathjeve të tjera – pesëqindë euro (500 €);
  - 1.103. Sharrimi dhe punimi i drurit – dyqindë euro (200 €);
  - 1.104. Prodhimi i fletëzave të rimesos dhe të panelave bazuar në drudë dyqindë euro (200€);
  - 1.105. Prodhimi i parketit për dysheme – pesëqindë euro (500 €);

- 1.106. Prodhimi i karpentiriesë dhe zdrukthëtarisë tjetër të ndërtimit–katërqind euro(400 €);
- 1.107. Prodhimi i kontejnerëve nga druri - dyqind euro (200 €);
- 1.108. Prodhimi i produkteve tjerë nga druri; prodhimi i artikujve nga tapa, kashta dhe materiali gërshetues(thurur) - treqind euro (300 €);
- 1.109. Prodhimi i brumit të letrës treqind euro (300 €)
- 1.110. Prodhimi i letrës dhe i kartuçit - treqind euro (300 €);
- 1.111. Prodhimi i letrës dhe i kartuçit të valëzuar dhe ambalazhit prej letre dhe kartuçi treqind euro (300 €);
- 1.112. Prodhimi i artikujve prej letre me përdorim sanitar ose shtëpiak dhe i letrës së toaletit - treqind euro (300 €);
- 1.113. Prodhimi i materialit prej letre për zyre - treqind euro (300 €);
- 1.114. Prodhimi i tapetave të mureve - treqind euro (300 €);
- 1.115. Prodhimi i artikujve të tjerë prej letre dhe kartuçi - treqind euro (300 €);
- 1.116. Botimi i gazetave – treqind euro (300 €);
- 1.117. Botime (printime) tjera – treqind euro (300 €);
- 1.118. Shërbimet e përgatitjes për shtyp dhe botim – dyqind euro (200 €);
- 1.119. Lidhja e librave dhe shërbime të ngjashme – treqind euro (300 €);
- 1.120. Riprodhimi i materialeve të incizuara - dyqind euro (100 €);
- 1.121. Koksifikimi i qymyrit – katërqind euro (400 €);
- 1.122. Prodhimi i produkteve të naftës së rafinuar një mij euro (1000 €);
- 1.123. Prodhimi i gazrave industrial- një mijë euro (1000 €);
- 1.124. Prodhimi i ngjyrave dhe pigmenteve – pesëqind euro (500 €);
- 1.125. Prodhimi i produkteve të tjera kimike inorganike – treqind euro (300 €);
- 1.126. Prodhimi i produkteve të tjera kimike organike – treqind euro (300 €);
- 1.127. Prodhimi i plehrave artificial dhe përbërësve nitrogjenik – një mijë euro (1000 €);
- 1.128. Prodhim i plastikës në forma primare – katërqind euro (400 €);
- 1.129. Prodhimi i gomës sintetikë në format primare – katërqind euro (400 €);
- 1.130. Prodhimi i pesticideve dhe i produkteve të tjera organike–dyqind euro(200€)
- 1.131. Prodhimi i ngjyrave, llaqeve dhe shtresave të ngjashme, ngjyrës së printimit dhe mastikës- pesëqind euro (500 €);
- 1.132. Prodhimi i sapunëve, deterxhenteve dhe i produkteve të pastrimit e shkëlqimi pesëqind euro (500 €);
- 1.133. Prodhimi i parfumeve dhe i preparateve kozmetike e të tualetit–katërqind euro(400€);
- 1.134. Prodhimi i eksploziveve – një mijë euro (1000 €);
- 1.135. Prodhimi i ngjitësit – katërqind euro (400 €);
- 1.136. Prodhimi i vajit eterik – katërqind euro (400 €);
- 1.137. Prodhimi i produkteve tjera kimike p.k.t. – katërqind euro (400 €);
- 1.138. Prodhimi i fibrave sintetike dhe artificiale – katërqind euro (400 €);
- 1.139. Prodhimi i produkteve bazike farmaceutike – katërqind euro (400 €);
- 1.140. Prodhimi i preparateve farmaceutike – katërqind euro (400 €);
- 1.141. Prodhimi i gomave të jashtme dhe të brendshme të automjeteve; rimbushja e rindërtimi i gomave – një mijë euro (1000 €);
- 1.142. Prodhimi i produkteve tjera të gomës – pesëqind euro (500 €)

- 1.143. Prodhimi i pllakave të plastikës, fletave, gypave dhe profile. katërqind euro (400 €);
- 1.144. Prodhimi i artikujve plastik të paketimit – treqind euro (300 €);
- 1.145. Prodhimi i artikujve të plastikës për ndërtimtari – treqind euro (300 €);
- 1.146. Prodhimi i produkteve tjerë të plastikës – dyqind euro (200 €);
- 1.147. Prodhimi i qelqit të rrafshët – treqind euro (300 €);
- 1.148. Dhënia e formës dhe procesimi i qelqit të rrafshët – treqind euro (300 €);
- 1.149. Prodhimi i qelqit të lugët (shishet, gotat etj.) – dyqind euro (200 €);
- 1.150. Prodhimi i fijeve të qelqit – dyqind euro (200 €);
- 1.151. Prodhimi dhe përpunimi i produkteve të tjera prej qelqi duke përfshirë edhe mallin teknik prej qelqi – dyqind euro (200 €);
- 1.152. Prodhimi i produkteve zjarrdurrues – dyqind euro (200 €);
- 1.153. Prodhimi i pllakave të qeramikës – dy mijë euro (2000 €);
- 1.154. Prodhimi i tullave, tjegullave dhe produkteve ndërtimore në argjilë të pjekur – dymijë euro (2000 €);
- 1.155. Prodhimi i produkteve qeramike për përdorim shtëpiak dhe zbukurues – një mijë euro (1000 €);
- 1.156. Prodhimi i instalimeve sanitare të qeramikës – një mijë euro (1000 €);
- 1.157. Prodhimi i izolatorëve dhe pjesëve izoluese prej qeramike – një mijë euro (1000€);
- 1.158. Prodhimi i produkteve tjerë teknik të qeramikës – një mijë euro (1000 €);
- 1.159. Prodhimi i produkteve tjerë të qeramikës – një mijë euro (1000 €);
- 1.160. Prodhimi i çimentos – dhjetë mijë euro (10000 €)
- 1.161. Prodhimi i gëlqeres dhe llaçit – pesë mijë euro (5000 €);
- 1.162. Prodhimi i produkteve të betonit për qëllime të ndërtimitarisë- një mijë euro (1000 €);
- 1.163. Prodhimi i produkteve të llaçit për qëllime të ndërtimitarisë – pesëqind euro (500 €);
- 1.164. Prodhimi i betonit të përzier të gatshëm – pesëqind euro (500€);
- 1.165. Prodhimi i allçit dhe betonit të thatë – pesëqind euro (500 €);
- 1.166. Prodhimi i produkteve me fibra të çimentuara – katërqind euro (400 €);
- 1.167. Prodhimi i produkteve të tjera me beton, çimento dhe allci – dyqind pesëdhjetë euro (250 €);
- 1.168. Thyerja e gurit, dhënia e formës dhe finicioni – një mijë euro (1000 €);
- 1.169. Prodhimi i produkteve gërryese – pesë mijë euro (5000€);
- 1.170. Prodhimi i produkteve tjerë të mineraleve jo metalike p.k.t. – pesë mijë euro (5000€)
- 1.171. Prodhimi i metalit të hekurit, çelikut dhe ferolegurave – pesë mijë euro (5000 €);
- 1.172. Prodhimi i tubave, gypave, profileve bosh dhe pajisjeve tjera nga çeliku- një mijë euro (1000€);
- 1.173. Tërheqja e ftohtë e shufrave – pesëqind euro (500 €);
- 1.174. Mbështjellja e ftohtë e rripave të ngushtë – pesëqind euro (500 €);
- 1.175. Formimi apo palosja e ftohtë – treqind euro (300 €);
- 1.176. Tërheqja e ftohtë e telit – treqind euro (300 €);
- 1.177. Prodhimi i metaleve të çmuara – pesëqind euro (500 €);
- 1.178. Prodhimi i aluminit – pesëqind euro (500 €);
- 1.179. Prodhimi i plumbit, zinkut dhe kallajit – dhjetë mijë euro (10000 €)
- 1.180. Prodhimi i bakrit – pesë mijë euro (5000 €);

- 1.181. Prodhimi i metaleve tjerë me ngjyrë – njëmijë euro (1000 €);
- 1.182. Derdhja e hekurit – njëmijë euro (1000 €);
- 1.183. Derdhja e çelikut – njëmijë euro (1000 €);
- 1.184. Derdhja e metaleve të lehta – njëmijë euro (1000 €);
- 1.185. Derdhja e metaleve tjerë me ngjyrë – pesëqind euro (500 €);
- 1.186. Prodhimi i strukturave të metalit dhe pjesëve të strukturave–dyqind euro (200€);
- 1.187. Prodhimi i dyerve dhe dritareve të metalit – dyqind euro (200 €);
- 1.188. Prodhimi i radiatorëve dhe prodhimi i kazanëve me avull, për ngrohje qendrore katërqind euro (400 €);
- 1.189. Prodhimi i tankerëve tjerë rezervarëve dhe kontejnerëve tjerë të metalit – katërqind euro (400 €);
- 1.190. Prodhimi i kazanëve me avull, përveç kazanëve për nxehje qendrore me ujë të ngrohtë – katërqind euro (400 €);
- 1.191. Prodhimi i armëve dhe municionit – njëmijë euro (1000 €);
- 1.192. Farkimi, presimi, stampimi dhe profilizimi i metodave dhe metalurgjia epluhurit - katërqind euro (400 €);
- 1.193. Trajtimi dhe veshja e metaleve – treqind euro (300 €);
- 1.194. Përpunimi mekanik – dyqind euro (200 €);
- 1.195. Prodhimi i artikujve prerës (thikë, pirun etj.) – dyqind euro (200€);
- 1.196. Prodhimi i bravave dhe çivive – dyqind euro (200 €);
- 1.197. Prodhimi i veglave – dyqind euro (200 €);
- 1.198. Prodhimi i daulleve të çelikut dhe kontejnerëve të ngjashëm-gjashtëqind euro (600€);
- 1.199. Prodhimi i paketimit të lehtë të metalit – katërqind euro (400 €);
- 1.200. Prodhimi i produkteve të telit, zinxhirëve dhe sustave – katërqind euro (400 €);
- 1.201. Prodhimi i shtrënguesve dhe i produkteve të vidhave të makinave-gjashtëqind euro (600 €);
- 1.202. Prodhimi i produkteve tjerë të fabrikuara të metalit p.k.t. - treqind euro (300 €);
- 1.203. Prodhimi i komponentëve elektronike – treqind euro (300€);
- 1.204. Prodhimi i tabelave elektronike nën tension – treqind euro (300 €);
- 1.205. Prodhimi i kompjuterëve dhe pajisjeve periferike – treqind euro (300 €);
- 1.206. Prodhimi i pajisjeve të komunikimit – treqind euro (300 €);
- 1.207. Prodhimi i elektronikës të konsumatorit – dyqind euro (200 €);
- 1.208. Prodhimi i instrumenteve dhe pajisjeve për matje, testim dhe navigacion –treqind euro (300 €);
- 1.209. Prodhimi i orëve të dorës dhe të murit – dyqind euro (200 €);
- 1.210. Prodhimi i pajisjeve të rrezatimit, elektro medicinale dhe elektro terapeutike – katërqind euro (400 €);
- 1.211. Prodhimi i instrumenteve optike dhe pajisjeve fotografike – katërqind euro (400 €);
- 1.212. Prodhimi i mediave magnetike dhe optike – treqind euro (300 €);
- 1.213. Prodhimi i motorëve elektrik,gjeneratorëve dhe transformatorëve–treqind euro(300€);
- 1.214. Prodhimi i aparateve të shpërndarjes dhe kontrollit të rrymës–treqind euro(300€);
- 1.215. Prodhimi i baterive dhe akumulatorëve– katërqind euro (400 €);

- 1.216. Prodhimi i telave dhe kabllave të tjerë elektronik dhe elektrik-treqind euro(300€);
- 1.217. Prodhimi i aparateve elektrike – treqind euro (300 €);
- 1.218. Prodhimi i pajisjeve të ndriçimit elektrik – treqind euro (300 €);
- 1.219. Prodhimi i aparateve elektrike shtëpiake – dyqind euro (200 €);
- 1.220. Prodhimi i aparateve shtëpiake jo elektrike- dyqind euro (200 €);
- 1.221. Prodhimi i pajisjeve të tjera elektrike – dyqind euro (200 €);
- 1.222. Prodhimi i motorëve dhe turbinave, përveç avionëve dhe të motorëve të automjeteve e çikletave - katërqind euro (400 €);
- 1.223. Prodhimi i pajisjeve me fuqi hidraulike – treqind euro (300 €);
- 1.224. Prodhimi i pompave dhe kompresorëve të tjerë – treqind euro (300 €);
- 1.225. Prodhimi i rubineteve dhe valvuleve – treqind euro (300 €);
- 1.226. Prodhimi i stufave, furrave dhe djegësve tjerë të furrave – treqind euro (300 €);
- 1.227. Prodhimi i pajisjeve të ngritjes dhe të manovrimit – treqind euro (300 €);
- 1.228. Prodhimi i pajisjes dhe makinerisë për zyre (përveç kompjuterëve dhe pajisjeve periferike) – treqind euro (300 €);
- 1.229. Prodhimi i veglave të operuara me fuqi dore – dyqind euro (200 €);
- 1.230. Prodhimi i pajisjeve jo shtëpiake për ftohje dhe ventilim – dyqind euro (200 €);
- 1.231. Prodhimi i makinerisë tjetër për qëllime të përgjithshme -p.k.t.–dyqind euro (200 €);
- 1.232. Prodhimi i makinerisë bujqësore dhe të pylltarisë – dyqind euro (200€);
- 1.234. Prodhimi i veglave për prodhimin e makinerisë dhemakina dyqind euro (200 €);
- 1.235. Prodhimi i veglave të tjera të makinave – dyqind euro (200 €);
- 1.236. Prodhimi i makinerisë për metalurgji – dyqindepesëdhjetë euro (250 €);
- 1.237. Prodhimi i makinerisë për miniera, gurëthyes dhe ndërtimtari – treqind euro(300 €);
- 1.238. Prodhimi i makinave për industrinë e ushqimit, te pijeve, duhanit–treqind euro(300 €);
- 1.239. Prodhimi i makinerisë për prodhimin e tekstilit, rrobave dhe të lëkurës- dyqindepesëdhjetë (250 €);
- 1.240. Prodhimi i makinerisë të plastikës dhe gomës – dyqindepesëdhjetë euro (250 €);
- 1.241. Prodhim i makinerisë tjetër për qëllime speciale p.k.t. – dyqind euro (200 €);
- 1.242. Prodhimi i mjeteve motorike – treqind euro (300 €);
- 1.243. Prodhimi i elektrike dhe elektronike për mjetet motorike – treqind euro (300 €);
- 1.244. Prodhimi i pjesëve dhe aksesorëve tjerë për mjetet motorike–treqind euro(300€);
- 1.245. Ndërtimi i barkave për zbavitje sportive – dyqind euro (200 €);
- 1.246. Prodhimi i lokomotivave dhe të inventarit të hekurudhave – njëmijë euro (1000 €);
- 1.247. Prodhimi i makinerisë i transportit ajror dhe i anijeve kozmike pesëmijë euro (5000€);
- 1.248. Prodhimi i motoçikletave – pesëqind euro (500 €);
- 1.249. Prodhimi i biçikletave dhe karraceve për invalidë – dyqind euro (200 €);
- 1.250. Prodhimi i mjeteve tjera të transportit p.k.t. – njëmijë euro (1000 €);
- 1.251. Prodhimi i mobilierisë për zyre dhe shitore – katërqind euro (400 €);
- 1.252. Prodhimi i mobileve të kuzhinës – dyqind euro (200 €);
- 1.253. Prodhimi i dyshekëve – dyqind euro (200 €);
- 1.254. Prodhimi i mobileve tjera – dyqind euro (200 €);

- 1.255. Shtypja e monedhave – treqind euro (300 €);
- 1.256. Prodhimi i argjendarisë dhe artikujve tjerë – dyqind euro (200 €);
- 1.257. Prodhimi i argjendarisë dhe artikujve të saj të imituar – njëqind euro (100 €);
- 1.258. Prodhimi i instrumenteve muzikor - njëqind euro (100 €);
- 1.259. Prodhim i artikujve sportive – njëqind euro (100 €);
- 1.260. Prodhimi i lojërave dhe lodrave - dyqind euro (200 €);
- 1.261. Prodhimi i instrumenteve mjekësore dhe dentalë dhe i furnizimeve–dyqind euro(200€);
- 1.262. Prodhimi i fshesave dhe brushave – dyqind euro (200 €);
- 1.263. Prodhimi tjetër p.k.t. – dyqind euro (200 €);
- 1.264. Riparimi i produkteve të fabrikuara të metalit – njëqind euro (100 €);
- 1.265. Riparimi i makinerisë – njëqind euro (100 €);
- 1.267. Riparimi i pajisjeve elektronike dhe optike – njëqind euro (100 €);
- 1.268. Riparimi i pajisjeve elektrike – njëqind euro (100 €);
- 1.269. Riparimi dhe mirëmbajtja e avionëve dhe anijeve kozmike-pesëqind euro(500 €);
- 1.270. Riparimi dhe mirëmbajtja e mjeteve tjera të transportit – dyqind euro (200 €);
- 1.271. Riparimi i mjeteve tjera – njëqindpesëdhjetë euro (150 €);
- 1.272. Instalimi i makinerisë dhe pajisjeve industriale–njëqindpesëdhjetë euro(150 €);
- 1.273. Prodhimi i rrymës elektrike – shtatmijëpesqind euro (7500 €);
- 1.274. Transmisioni i rrymës – shtatmijepesqind euro (7500 €);
- 1.275. Distribuim i rrymës – njëmijë euro (1000 €);
- 1.276. Tregtimi i rrymës – njëmijë euro (1000 €);
- 1.277. Prodhim i gazit – pesmijë euro (5000 €);
- 1.278. Distribuimi i lëndëve të gazit përmes stacioneve shpërndarës – njëmijë euro (1000 €);
- 1.279. Tregtimi i gazit përmes stacioneve shpërndarës – njëmijë euro (1000 €);
- 1.280. Furnizimi me avull dhe klimatizim – dymijë euro (2000 €);
- 1.281. Grumbullimi i ujit, trajtimi dhe furnizimi – treqind euro (300 €);
- 1.282. Kanalizimi – treqind euro (300 €);
- 1.283. Grumbullimi i mbeturinave jo të rrezikshme – treqind euro (300 €);
- 1.284. Grumbullimi i mbeturinave të rrezikshme – treqind euro (300 €);
- 1.285. Trajtimi dhe asgjësimi i mbeturinave jo të rrezikshme – treqind euro (300 €);
- 1.286. Trajtimi dhe asgjësimi i mbeturinave të rrezikshme – pesëqind euro (500 €);
- 1.287. Çmontimi i mbeturinave të metalta – treqind euro (300 €);
- 1.288. Ripërpunimi i materialeve të klasifikuara – pesëqind euro (500 €);
- 1.289. Aktivitetet e riparimit dhe shërbimet tjera të menaxhimit të mbeturinave–treqind euro (300 €);
- 1.290. Zhvillimi i projekteve ndërtimore – njëmijë euro (1000 €);
- 1.291. Ndërtimi i objekteve banesore dhe jo banesore – njëmijë euro (1000 €);
- 1.292. Ndërtimi i rrugëve dhe autostradave – njëmijë euro (1000 €);
- 1.293. Ndërtimi i hekurudhave dhe i atyre nëntokësore-metrove–dymijë euro(2000€);
- 1.294. Ndërtimi i urave dhe tuneleve – njëmijë euro (1000 €);
- 1.295. Ndërtimi i projekteve të kanalizuarra për fluide dhe gazra–pesëqind euro(500 €);
- 1.296. Ndërtimi i projekteve të shërbimeve publike për rrymë eklektike dhe telekomunikime – katërqind euro (400 €);

- 1.297. Ndërtimi i projekteve të ujit – katërqind euro (400 €);
- 1.298. Ndërtimi i projekteve tjera të ndërtimit civil p.k.t. – treqind euro (300 €);
- 1.299. Demolimi i objekteve – treqind euro (300 €);
- 1.300. Përgatitja e vend punishtes – treqind euro (300 €);
- 1.301. Testi i birit dhe shpimit – treqind euro (300 €);
- 1.302. Instalimi elektrik – treqindpesëdhjetë euro (350 €);
- 1.303. Instalimi i hidraulikës, ngrohjes dhe të kondicionimit të ajrit–treqindpesëdhjetë euro (350 €);
- 1.304. Instalime tjera ndërtimore – treqindpesëdhjetë euro (350 €);
- 1.305. Suvatimi – dyqind euro (200 €);
- 1.306. Instalimi i zdrukthëtarisë – dyqind euro (200 €);
- 1.307. Shtrimi i dyshemesë dhe veshja e mureve – dyqind euro (200 €);
- 1.308. Lyerja dhe lustrimi – dyqind euro (200 €);
- 1.309. Përfundimet dhe mbarimet tjera të ndërtesës – dyqind euro (200 €);
- 1.310. Aktivitetet e kulmit- çatisë – dyqind euro (200 €);
- 1.311. Aktivitetet tjera të specializuara të ndërtimit p.k.t. – dyqind euro (200 €);
- 1.312. Shitja e veturave dhe mjeteve të lehta motorike – dyqind euro (200€);
- 1.313. Shitja e mjeteve tjera motorike – dyqind euro (200 €);
- 1.314. Mirëmbajtja dhe riparimi i mjeteve motorike – njëqind euro (100 €);
- 1.315. Shitja me shumicë e pjesëve dhe aksesorëve të mjeteve motorike–dyqind euro(200€);
- 1.316. Shitja me pakicë e pjesëve dhe aksesorëve të mjeteve motorike–dyqind euro(200€);
- 1.317. Shitja, mirëmbajtja dhe riparimi i motoçikletave dhe pjesëve e aksesorëve të tyre–dyqind euro (200 €);
- 1.318. Ndërmjetësimi në shitjen e lëndëve të para bujqësore, kafshëve të gjalla, lëndëvetë para dhe artikuj gjysmë final – dyqind euro (200 €);
- 1.319. Ndërmjetësimi në shitjen e karburanteve, mineraleve, metaleve dhe kimikaleve industriale – njëmijë euro (1000 €);
- 1.320. Ndërmjetësimi në shitjen e lëndës së drurit dhe materialit ndërtimor – katërqind euro (400 €);
- 1.321. Ndërmjetësimi në shitjen e makinerisë, pajisjeve industriale, anijeve dhe avionëve – katërqind euro (400 €);
- 1.322. Ndërmjetësimi në shitjen mobileve, artikujve shtëpiak, aparateve elektrike dhe hekurishte – treqind euro (300 €);
- 1.323. Ndërmjetësimi në shitjen e tekstileve, rrobave, gëzofit, veshmbathjes e artikujvetë lëkurës – treqind euro (300 €);
- 1.324. Ndërmjetësimi në tregti e ushqimit, pijeve dhe duhanit – treqind euro (300 €);
- 1.325. Ndërmjetësimet tjera të specializuar në shitjen e produkteve tjerë të veçantë – treqind euro (300 €);
- 1.326. Ndërmjetësimi në tregtinë e produkteve të ndryshme – treqind euro (300 €);
- 1.327. Shitja me shumicë e drithit, duhanit të papërpunuar, farërave dhe ushqimeve të kafshëve – treqind euro (300€);
- 1.328. Shitja me shumicë e luleve dhe bimëve – njëqind euro (100 €);
- 1.329. Shitja me shumicë e kafshëve të gjalla – dyqind euro (200 €);

- 1.330. Shitja me shumicë e lëkurave të papërpunuara, lëkurave dhe artikujve prej lëkure – njëqind euro (100 €);
- 1.331. Shitja me shumicë e frutave dhe perimeve – treqind euro (300 €);
- 1.332. Shitja me shumicë e mishit dhe produkteve të mishit – pesëqind euro (500 €);
- 1.333. Shitja me shumicë e produkteve të qumështit, vezëve, vajrave e yndyraveushqyese – treqind euro (300 €);
- 1.334. Shitja me shumicë e pijeve – treqind euro (300 €);
- 1.335. Shitja me shumicë e produkteve të duhanit – treqind euro (300 €);
- 1.336. Shitja me shumicë e sheqerit, e çokollatës dhe të ëmbëlsirave të sheqerit – treqind euro (300 €);
- 1.337. Shitja me shumicë e kafesë, çajit, kakaos dhe erëzave – treqind euro (300 €);
- 1.338. Shitja me shumicë e ushqimeve tjerë, përfshirë peshqit, krustacëve dhemoluskëve (frutave te detit) – treqind euro (300 €);
- 1.339. Shitje me shumicë jo e specializuar e ushqimit, pijeve dhe duhanit – pesëqinde euro (500 €);
- 1.340. Shitja me shumicë e tekstileve – treqind euro (300€);
- 1.341. Shitja me shumicë e rrobave dhe veshmbathjes – treqind euro (300€);
- 1.342. Shitja me shumicë e aparateve elektrike shtëpiake treqind euro (300 €);
- 1.343. Shitja me shumicë e porcelanit dhe artikujve të xhamit dhe të materialeve pastruese dyqind (200 €);
- 1.344. Shitja me shumicë e parfumeve dhe kozmetikës – dyqind euro (200 €);
- 1.345. Shitja me shumicë e mallrave farmaceutik – treqind euro (300 €);
- 1.346. Shitja me shumicë e mobileve, qilimave dhe pajisjeve të ndriçimit – treqind euro (250 €);
- 1.347. Shitja me shumicë e orëve dhe të artikujve të argjendarisë – dyqind euro (200 €);
- 1.348. Shitja me shumicë e artikujve tjerë shtëpiak – dyqind euro (200 €);
- 1.349. Shitja me shumicë e kompjuterëve, pajisjeve periferikë dhe harduerëve të kompjuterëve – treqind euro (300 €);
- 1.350. Shitja me shumicë e pajisjeve dhe pjesëve elektronike dhe të telekomunikimit – treqind euro (300 €);
- 1.351. Shitja me shumicë e makinerisë bujqësore, pajisjeve dhe furnizimeve – treqindeuro (300 €);
- 1.352. Shitja me shumicë e makinave metalprerëse – treqind euro (300 €);
- 1.353. Shitja me shumicë e makinerisë të minierave, ndërtimtarisë dhe ndërtimit civil- Katërqind euro (400 €);
- 1.354. Shitja me shumicë e makinerisë për industrinë e tekstitit dhe të makinave, të qepjes dhe thurjes – treqind euro (300 €);
- 1.355. Shitja me shumicë e mobileve të zyrave – treqind euro (300 €);
- 1.356. Shitja me shumicë e makinerisë dhe pajisjeve tjera të zyrave – treqindepesëdhjetë euro (250 €);
- 1.357. Shitja me shumicë e makinerisë dhe pajisjeve tjera – treqind euro (300 €);
- 1.358. Shitja me shumicë e produkteve të ngurta, lëngtë dhe lëndëve djegëse të gaztaetj – njëmijë euro (1000 €);

- 1.359. Shitja me shumicë e metaleve dhe xeheve të metalit – një mijë euro (1000 €);
- 1.360. Shitja me shumicë e drurit, materialeve ndërtimore dhe pajisjeve sanitare – katër qind euro (400 €);
4.	Tarifa për regjistrimin e njësisë kadastrale të krijuar nga ndarja apo bashkimi është njëzet (20€) euro për njësi.	20.00€

<b>Tarifa e regjistrimit të ndarjes së bashkëpronësisë apo pronësisë së përbashkët</b>		
1.	Tarifa për regjistrimin e pronësisë në bazë bazë të ndarjes nga bashkëpronësia apo pronësia e përbashkët për secilin bashkëpronar që bëhet pronarë individual është tridhjetë (30€) euro.	30.00€

<b>Tarifa e regjistrimit të pronësisë në bazë të trashëgimisë dhe të shkëputjes nga bashkësisë familjare</b>		
1.	Tarifa për çdo trashëgimtar për regjistrimin e pronësisë në bazë të trashëgimisë është dhjetë (10€) euro.	10.00€
2.	Tarifa për çdo trashëgimtar për regjistrimin e pronësisë në bazë të trashëgimisë, e cila rrjedh nga testamenti është njëzet (20€) euro.	20.00€
3.	Tarifa për regjistrimin e pronësisë në bazë të shkëputjes së bashkësisë familjare për çdo anëtar të familjes që bëhet pronar është njëzet (20€) euro.	20.00€

<b>Tarifat e regjistrimit të pronësisë në bazë të ndërrimit/këmbimit të pronës së paluajtshme</b>		
1.	Tarifa për regjistrimin e pronësisë në bazë të ndërrimit/këmbimit të pronës së paluajtshme për secilin pronar është katërdhjetë (40€) euro.	40.00€

<b>Tarifa për regjistrimin e të drejtës së shfrytëzimit-qirambajtjes</b>		
1.	Tarifa për regjistrimin të drejtës së shfrytëzimit- qirambajtjes për çdo njësi kadastrale, kur pronar është Qeveria apo Komuna, me kohëzgjatje deri në 10 vite është dhjetë (10€) euro.	10.00€
2.	Tarifa për regjistrimin të drejtës së shfrytëzimit- qirambajtjes për çdo njësi kadastrale, kur pronar është Qeveria apo Komuna, me kohëzgjatje prej dhjetë(10) vite deri katërdhjetë(40) vite është tridhjetë (30€) euro.	30.00€
3.	Tarifa për regjistrimin të drejtës së shfrytëzimit- qirambajtjes për çdo njësi kadastrale, kur pronar është Qeveria apo Komuna, me kohëzgjatje prej katërdhjetë(40) vite deri nëntëdhjetë e nëntë(99) vite është pesëdhjetë (50€)euro.	50.00€

4.	Tarifa për regjistrimin e qirasë nga personi fizik apo juridik në kohëzgjatje deri në dhjetë(10) vite për çdo njësi kadastrale është dhjetë (10€) euro.	10.00€
5.	Tarifa për regjistrimin e qirasë nga personi fizik apo juridik në kohëzgjatje mbi dhjetë(10) vite për çdo njësi kadastrale është njëzet (20€) euro.	20.00€

### Tarifat për regjistrimin e Hipotekës

Tarifat për regjistrimin e Hipotekës sipas vlerës së kredisë të përcaktuar me dokumentin e hipotekës është:		
1.1	Deri në tridhjetëmijë (30.000) euro është njëzet (20€) euro;	20.00€
1.2	Prej tridhjetëmijë e një (30.001) euro deri në pesëdhjetëmijë (50.000) euro është tridhjetë (30€) euro;	30.00€
1.3	Prej pesëdhjetëmijë e një (50.001) euro deri në njëqindmijë (100.000) euro është gjashtëdhjetë (60€) euro;	60.00€
1.4	Prej njëqindmijë e një (100.001) euro deri në dyqindmijë (200.000) euro është nëntëdhjetë (90€) euro;	90.00€
1.5	Prej dyqindmijë e një (200.001) euro deri në pesqindmijë (500.000) euro është njëqind e njëzet (120€) euro;	120.00€
1.6	Prej pesqindmijë e një (500.001) euro deri në njëmilion (1.000.000) euro është dyqind e katërdhjetë (240€) euro;	240.00€
1.7	Mbi vlerën e njëmilion (1.000.000) euro, tarifa është katërqind (400€) euro.	400.00€

### Tarifat për modifikimin dhe fshirjen e hipotekës

1.	Tarifa për modifikimin e hipotekës së regjistruar është dhjetë (10€) euro.	10.00€
2.	<b>Në rastet e ndryshimit të vlerës së kredisë duhet të aplikohen këto tarifa:</b>	20.00€
	1. Deri në tridhjetëmijë (30.000) euro është njëzet (20€) euro;	
	2. Prej tridhjetëmijë e një (30.001) euro deri në pesëdhjetëmijë (50.000) euro është tridhjetë (30€) euro;	30.00€
	3. Prej pesëdhjetëmijë e një (50.001) euro deri në njëqindmijë (100.000) euro është gjashtëdhjetë (60€) euro;	60.00€
	4. Prej njëqindmijë e një (100.001) euro deri në dyqindmijë (200.000) euro është nëntëdhjetë (90€) euro;	90.00€
	5. Prej dyqindmijë e një (200.001) euro deri në pesqindmijë (500.000) euro është njëqind e njëzet (120€) euro;	120.00€
	6. Prej pesqindmijë e një (500.001) euro deri në njëmilion (1.000.000) euro është dyqind e katërdhjetë (240€) euro;	240.00€
	7. Mbi vlerën e njëmilion (1.000.000) euro, tarifa është katërqind (400€) euro.	400.00€

### Tarifa për regjistrimin, modifikimin dhe fshirjen e servitutit

1.	Tarifa për regjistrimin e të drejtës së servitutit për secilën parcelë dominante apo person është tridhjetë (30€) euro.	30.00€
2.	Tarifa për modifikimin e servitutit është dhjetë (10€) euro.	10.00€

3.	Tarifa për fshirjen e servitutit nga Regjistri është njëzet (20€) euro.	20.00€
----	---	--------

<b>Tarifa për regjistrimin, modifikimin dhe fshirjen e barrave dhe ngarkesave tjera</b>		
1.	Trifa për regjistrimin e vërejtjes sipas Ligjit për Regjistrimin e të Drejtave të Pronës Paluajtshme është katërdhjetë (40€) euro.	40.00€
2.	Tarifa për regjistrimin e ndalesës nga përmbaruesit privat apo Gjykata në procedure përmbarimore për çdo akt juridik është tridhjetë (30€) euro.	30.00€
3.	Tarifa për regjistrimin e vërejtjes të mbajtësit në pronën e paluajtshme të të mbajturit në momentin e lidhjes së Kontratës mbi mbajtej e përjetshme është njëzet (20€)	20.00€

<b>Tarifa për korrigjimin e të dhënave kadastrale</b>		
1.	Tarifa për korrigjimin e të dhënave kadastrale që konstatohet se janë regjistruar gabim si pasojë e dokumentacionit të dorëzuar nga palët është tridhjetë (30€) euro.	30.00€

<b>Tarifa për shërbimet online</b>		
1.	Tarifa për nxjerrjen e certifikatave online është tri (3€) euro.	3.00€

<b>Tarifa për regjistrimin e të drejtave tjera</b>		
1.	Tarifa për regjistrimin e të drejtave të cilat nuk janë përfshirë me dispozitat e këtij Udhëzimi Administrativ është pesëdhjetë (50€) euro.	50.00€

**Tabela Nr. 3 – Taksa dhënien e lejes mjedisore sipas Udhëzimit Administrativ MMPH – Nr. 01/2017 për Dhënien e Lejes Komunale Mjedisore**

Nr	Leja mjedisore	Taksa
1.	Leja mjedisore komunale për projektet në vlerë investive deri në 25.000 €	50.00 €
2.	Leja mjedisore komunale për projektet në vlerë investive mbi 25.000 €	2% e vlerës së projektit

**KAPITULLI IX**  
**TAKSA KOMUNALE PËR SHFRYTËZIMIN E OBJEKTEVE, HAPËSIRËS DHE**  
**TË MIRAVE PUBLIKE**

**Neni 26**

**Taksa mbi vendosjen e panove reklamuese**

1. Çdo shoqëri tregtare që ekspozon pano reklamuese në pronën e tij private apo të marrë në shfrytëzim apo me qira, paguan taksë vjetore, si në vijim:
  - 1.1 Për panot reklamuese deri në dy metër në katror ( $2m^2$ ) – njëzetë euro (20 €)
  - 1.2 Për panot reklamuese deri në katër metër në katror ( $4m^2$ ) - tridhjetë euro (30 €);
  - 1.3 Për panot reklamuese deri në gjashtë metër në katror ( $6m^2$ ) - dyzetë euro (40 €);
  - 1.4 Për panot reklamuese deri në tetë metër në katror ( $8m^2$ ) - pesëdhjetë euro (50 €);
  - 1.5 Për panot reklamuese deri në dhjetë metër në katror ( $10m^2$ ) - gjetëdhjetë euro (60 €);
  - 1.6 Për panot reklamuese deri në pesëmbëdhjetë metër në katror ( $15m^2$ ) tetëdhjetë euro (80 €) dhe
  - 1.7 Për panot mbi pesëmbëdhjetë metër në katror ( $15m^2$ ) – njëqind euro (100 €).
2. **Çdo shoqëri tregtare që ekspozon pano reklamuese në hapësirën publike, paguanë taksë mujore si në vijim**
  - 2.1. Për panot në hapësirën publike në qytet – për një metër në katror një euro e dyzet cent ( $1.40 \text{ €/m}^2$ );
  - 2.2. Për panot reklamuese në hapësirën publike jashtë qytetit – tetëdhjetë cent për një metër në katror ( $0.80 \text{ € m}^2$ ); dhe
  - 2.3. Reklammat digjitale me ekran pronësi komunale në qytet –sheshe, pesë euro për një metër katror ( $5\text{€për } 1m^2$ )
  - 2.4. Për panot reklamuese elektronike – dhjetë përqind për një metër në katror nga vlera e panos reklamuse bazuar në pikën 2.1. dhe 2.2. të këtij neni ( $10\%/ \text{ € m}^2$ );
  - 2.5. Për panot reklamuese në hapësirën publike jashtë qytetit – shtatëdhjet cent për një metër në katror ( $0.70 \text{ € m}^2$ ); dhe
  - 2.6 Për panot reklamuese elektronike jashtë qytetit – tetëdhjetë cent për një metër në katror ( $0.80 \text{ € m}^2$ ).
3. Llogaritja e taksë sipas paragrafit 2 të këtij neni bëhet duke shumëzuar totalin e madhësisë së panos reklamuese me taksën komunale mujore.
4. Çdo shoqëri tregtare obligohet që të njoftojë Komunën për vendosjen një panoje sipas dispozitave të këtij neni, përveç atyre të paraparë në paragrafin 1 të këtij neni, brenda gjashtëdhjetë (60) dite nga data e vendosjes, duke specifikuar llojin dhe madhësinë e panos së vendosur.
5. Pagesa e taksës komunale për vendosjen e panove sipas këtij neni bëhet si në vijim:
  - 5.1 Për panot e vendosura sipas paragrafit 1 të këtij neni, pagesa vjetore bëhet deri më datën tridhjetë (30) shtator të vitit aktual; dhe
  - 5.2 Për panot e vendosura sipas paragrafit 2 të këtij neni, pagesa bëhet para datës së vendosjessë panos.

## Neni 27

### Taksa komunale mbi parkimin e automjeteve

1. Çdo person që shfrytëzon hapësirat komunale të destinuar për parkim të veturave, paguan taksë komunale sipas dispozitave të këtij neni.
2. Taksa komunale për parkimin e automjeteve paguhet si taksë mujore ose si taksë e shfrytëzimitin përkohshëm me orë qëndrimi të veturës.
3. Taksa komunale mujore për parkimin e automjeteve është si në vijim:
  - 3.1 Për personat juridik në Zonën I – njëzetë euro (20 €);
  - 3.2 Për personat fizik në Zonën I – dhjetë euro (10 €);
  - 3.3 Për personat juridik në Zonën II – pesëmbëdhjetë euro (15 €);
  - 3.4 Për personat fizik në Zonën II – dhjetë euro (10 €);
  - 3.5 Për personat juridik në Zonën III – tetë euro (8 €); dhe
  - 3.6 Për personat fizik në Zonën III – gjashtë euro (6 €)
4. Taksa komunale për parkim të përkohshëm për qëllim të ngarkimit apo shkarkimit të mallrave është dhjetë (10 €) në muaj.
5. Taksa komunale për shfrytëzimin e përkohshëm të parkingut komunal është si në vijim:
  - 5.1 Për personat juridik në Zonën I – pesëdhjetë cent (0.50 €) në orë;
  - 5.2 Për personat fizik në Zonën I – dyzetë cent (0.40 €) në orë;
  - 5.3 Për personat juridik në Zonën II – dyzetë cent (0.40 €) në orë;
  - 5.4 Për personat fizik në Zonën II – tridhjetë cent (0.30 €) në orë;
  - 5.5 Për personat juridik në Zonën III – tridhjetë cent (0.30 €) në orë; dhe
  - 5.6 Për personat fizik në Zonën III – njëzetë cent (0.20 €) në orë
6. Pagesa sipas paragrafit 3 dhe 4 të këtij neni bëhet në baza mujore apo në baza disa mujore, pas marrjes së pëlqimit nga organi përkatës komunal. Pagesa sipas paragrafit 5 të këtij neni bëhet pas marrjes së shërbimit.

## Neni 28

### Taksa komunale për vendosjen e objekteve të ndryshme në hapësirat publike

1. Çdo person që vendos objekte të ndryshme në hapësirat publike, paguan taksë komunale si në vijim:
  - 1.1. Vendosja e kiosqeve ose objekteve tjera montuese për veprimtari tregtare në Zonën I – katër euro për një metër në katror (4 €/m<sup>2</sup>) në muaj;
  - 1.2. Vendosja e kiosqeve ose objekteve tjera montuese për veprimtari tregtare në Zonën II – tre euro për një metër në katror (3€/m<sup>2</sup>) në muaj;
  - 1.3. Vendosja e kiosqeve ose objekteve tjera montuese për veprimtari tregtare në Zonën III – dy euro për një metër në katror (2€/m<sup>2</sup>) në muaj;
  - 1.4. Vendosja e kiosqeve ose objekteve tjera montuese për veprimtari tregtare në Zonën IV – një euro për një metër në katror (1€/m<sup>2</sup>) në muaj;

- 1.5. Vendorsja e tavolinave për shërbim para objektit ku ushtrohet veprimtaria ekonomike hoteliere në Zonën I – dy euro për tavolinë me (tavolinë katër karrike) (2.00 €/m<sup>2</sup>) në muaj;
- 1.6. Vendorsja e tavolinave për shërbim para objektit ku ushtrohet veprimtaria ekonomike hoteliere në Zonën II – një euro për një tavolinë (me katër karrika) (1.00 €/m<sup>2</sup>) në muaj;
- 1.7. Vendorsja e tavolinave për shërbim para objektit ku ushtrohet veprimtaria ekonomike në Zonën III – një euro për një tavolinë me (katër karrika) (0.80 €/m<sup>2</sup>) në muaj;
- 1.8. Vendorsja e mallrave për ekspozim para hapësirës ku ushtrohet veprimtaria ekonomike në Zonën I – dhjetë euro për një metër në katror (10 €/m<sup>2</sup>) në muaj;
- 1.9. Vendorsja e mallrave për ekspozim para hapësirës ku ushtrohet veprimtaria ekonomike në Zonën II – tetë euro për një metër në katror (8 €/m<sup>2</sup>) në muaj;
- 1.10. Vendorsja e mallrave për ekspozim para hapësirës ku ushtrohet veprimtaria ekonomike në Zonën III – pesë euro për një metër në katror (5 €/m<sup>2</sup>) në muaj;
- 1.11. Vendorsja e mallrave për ekspozim para hapësirës ku ushtrohet veprimtaria ekonomike në Zonën IV – tre euro për një metër në katror (3 €/m<sup>2</sup>) në muaj;
- 1.12. Vendorsja e standeve të hapura për shitjen e librave jo shkollore për veprimtari ekonomike në Zonën I – dhjetë euro (10 €) në muaj;
- 1.13. Vendorsja e standeve të hapura për shitjen e librave jo shkollore për veprimtari ekonomike në Zonën II – tetë euro (8 €) në muaj;
- 1.14. Vendorsja e standeve të hapura për shitjen e librave jo shkollore për veprimtari ekonomike në Zonën III – pesë euro (5 €) në muaj;
- 1.15. Vendorsja e pajisjeve për akullore dhe të ngjashme për veprimtari tregtare në Zonën I – dhjetë euro (10 €) në muaj;
- 1.16. Vendorsja e pajisjeve për akullore dhe të ngjashme për veprimtari tregtare në Zonën II – tetë euro (8 €) në muaj;
- 1.17. Vendorsja e pajisjeve për akullore dhe të ngjashme për veprimtari tregtare në Zonën III – pesë euro (5 €) në muaj;
- 1.18. Vendorsja e automjetit lëvizës për shitjen e ushqimit të shpejtë – njëzetë (20 €) në muaj;
- 1.19. Vendorsja e tendave (çadrave) të hapura lëvizëse me mekanizëm –katër euro për një metër në katror për (4 €/m<sup>2</sup>) në muaj;
- 1.20. Vendorsjen e lojërave të fëmijëve – një euro për një metër në katror (1.00€/ m<sup>2</sup>) në muaj;
- 1.21. Vendorsja e gjeneratorëve statik – pesë euro për një metër në katror (5 €/m<sup>2</sup>) në muaj;
- 1.22. Vendorsja e veturave për qëllime komerciale – dhjetë euro (10 €) në muaj;
- 1.23. Vendorsja e lojërave argëtuese në pronë private – njëzetë euro (20 €) në muaj;
- 1.24. Vendorsja e lojërave argëtuese në pronë komunale – njëqind euro (100 €) në muaj;
- 1.25. Vendorsja e kabllave të ndryshme në hapësirë për qëllime komerciale private – njëqind euro (100 €) në vit, si pagesë e njëhershme;
- 1.26. Vendorsja e kabllave të ndryshme nën tokë për qëllime komerciale private – treqind euro (300 €) në vit, si pagesë e njëhershme;
- 1.27. Vendorsja e ormanëve apo pasjeve tjera shpërndarës – njëqind euro (100 €) në vit;
- 1.28. Vendorsja e foltoreve telefonike – njëqind euro (100 €) në vit;
- 1.29. Vendorsja e antenave telekomunikuese – treqind euro (300 €) në vit; dhe
- 1.30. Vendorsja e bankomatëve nga institucionet financiare – njëqindë euro (100 €) në vit;

## Neni 29

### Taksa komunale për qëndrimin e veturave përjashtuara nga komunikacioni në parkingun e Komunës

1. Çdo person, të cilit i qëndron vetura në parkingun e komunës si pasojë e përjashtimit nga komunikacioni, paguan taksë si në vijim:
  - 1.1. Automjetet, motoçikletë dhe traktor – një euro e gjysmë (1.5 €) për një ditë;
  - 1.2. Mjetet tjera deri në tre tonë e gjysmë (3.5 t) - tre euro (3 €) për një ditë; dhe
  - 1.3. Mjetet mbi tre tonë e gjysmë (3.5 t) - pesë euro (5 €) për një ditë;
2. Lartësia e taksës së përcaktuar në paragrafin 1 të këtij neni zbatohet pesëdhjetë për qind (50 %), pas kalimit të nëntëdhjetë (90) ditëve të qëndrimit të veturës në parkingun e komunës.
3. Pagesa e taksës së përcaktuar në paragrafin një (1) të këtij neni bëhet para marrjes së veturës nga parkingu i Komunës dhe vetura nuk mund merret pa pagesën e taksës.

### Taksa komunale për bllokimin e rrugëve sekondare

1. Çdo person i cili pas marrjes së lejes përkatëse bën bllokimin e rrugëve sekondare të Komunës, paguan taksat si në vijim:
  - 1.1. Bllokimi i rrugës sekondare nga personat fizik deri në gjashtë (6) orë – pesë euro (5 €);
  - 1.2. Bllokimi i rrugës sekondare nga personat fizik nga gjashtë (6) deri në dymbëdhjetë (12) orë – dhjetë euro (10 €);
  - 1.3. Bllokimi i rrugës sekondare nga personat fizik nga dymbëdhjetë (12) deri në njëzet e katër (24) orë – njëzetë euro (20 €);
  - 1.4. Bllokimi i rrugës sekondare nga personat fizik mbi njëzet e katër (24) orë – njëzetë euro (20 €) për çdo ditë;
  - 1.5. Bllokimi i rrugës sekondare nga personat juridik deri në gjashtë (6) orë – pesëmbëdhjetë euro (15 €);
  - 1.6. Bllokimi i rrugës sekondare nga personat juridik nga gjashtë (6) deri në dymbëdhjetë (12) orë – tridhjetë euro (30 €);
  - 1.7. Bllokimi i rrugës sekondare nga personat juridik nga dymbëdhjetë (12) deri në njëzet e katër (24) orë – pesëdhjetë euro (50 €);
  - 1.8. Bllokimi i rrugës sekondare nga personat juridik mbi njëzet e katër (24) orë - pesëdhjetë euro (50 €) për çdo ditë.
2. Çdo person i cili pas marrjes së lejes përkatëse bën bllokimin e pjesëshëm të rrugëve sekondare të Komunës për qëllim të ndërtimit, paguan taksat ditore në vlerë prej dhjetë euro (10€).
3. Pagesa e taksës sipas paragrafit një (1) dhe dy (2) të këtij neni paguhet para bllokimit të rrugës sekondare.

Neni 30

**Taksa komunale për shfrytëzimin e përkohshëm të objekteve komuna**

1. Tarifat për shfrytëzimin e palestrës dhe fushave të hapura sportive

2. Tarifat në sferën e sportit

Nr. <b>1.</b>	<b>Stërvitja në palestër pa ndriçim</b>		
1.1	Stërvitjet e ekipeve sportive pa ndriçim vetëm palestra(për një orë)	Tarifa	<b>10.00€</b>
1.2	Stërvitjet e ekipeve në palestër dhe zhveshtorja (për një orë)	Tarifa	15.00€
1.3	Stërvitjet e ekipeve në palestër , me ndriçim (për një orë)	Tarifa	15.00€
<b>2.</b>	<b>Stërvitjet e ekipeve sportive me ndriçim</b>		
2.1	Stërvitjet e ekipeve sportive me ndriçim (për një orë )	Tarifa	15.00€
2.2	Stërvitjet e ekipeve sportive me ndriçim dhe zhveshtorja (për një orë ) Stërvitjet e ekipeve sportive me ndriçim,zhveshtorja dhe pastrami (për një orë)	Tarifa	20.00€
2.3		Tarifa	40.00€
<b>3.</b>	<b>Të gjitha klubet sportive që nuk janë në komunën e Obiliqit ,të cilat për shkaqe të ndryshme janë te interesuara të shfrytëzojnë Palestrën sportive duhet të paguajn për një orë</b>	Tarifa	100.00€
3.1	Stërvitjet e ekipeve sportive private pa ndriçim (për një orë )	Tarifa	10.00 €
3.2	Stërvitjet e ekipeve sportive private me ndriçim ( për një orë)	Tarifa	15.00 €
3.3	Stërvitjet e ekipeve sportive private me ndriçim ,tush kabinat e pastrimit dhe zhveshtorja për një orë	Tarifa	30.00 €
<b>4.</b>	<b>Për zhvillimin e ndeshjeve sportive në palestër</b>		
4.1	Për zhvillimin e ndeshjeve pa bileta për një orë	Tarifa	60.00€
4.2	Për zhvillimin e ndeshjeve me bileta në përqindje %		20%
<b>5.</b>	<b>Për shfrytëzimin e fushave sportive në futbollë:</b>		
5.1	Stërvitja ne fushat e hapura sportive pa ndriçim për një orë	Tarifa	<b>50.00 €</b>

5.2	Stërvitja ne fushat e hapura sportive me ndriçim për një orë	Tarifa	80.00€
5.3	Stërvitjet e e kipeve me ndriçim,zhveshtorja dhe tush kabina e pastrimit ,për një orë	Tarifa	100.00€
5.4	Për zhvillimin e ndeshjeve në futbollë pa ndriçim për një orë	Tarifa	100.00€
5.5	Për zhvillimin e ndeshjeve në futbollë me ndriçim për një orë		150.00€
5.6	Për zhvillimin e ndeshjeve me ndriçim,zhveshtorja dhe tush kabinat e pastrimit për një orë për një orë	Tarifa	200.00€
6.	<b>Lirohen nga pagesat</b>		
6.1	Për klubet e qytetit dhe shkollat e futbollit të komunës së Obiliqit është rregulluar me nenin.7.paragrafi 3të kësaj rregulloreje;	Lirim	
6.2	Për ndeshjet zyrtare si vendas pa pagesë;	Lirim	
6.3	Për ngjarjet hymanitare pa pagesë;	Lirim	
6.4	Tubimet përkujtimore;		
6.5	Tubimet e organizuara nga KK OBILIQ		
6.6	Shoqatat me aftësi të kufizuara;		
6.7	Shoqatat e dalura nga lufta ,familjet dhe invalidët e luftës;		
6.8	Bashkësitë fetare , familjet e dëshmorëve dhe veteranët		
7.	<b>Për ngjarjet komerciale ,panaire ,ekspozita rekreacione e të ngjajshme</b>		
7.1	Për ngjarjet komerciale ,panaire ,ekspozita rekreacione,për një orë	Tarifa	50.00€
7.2	Për koncerte të ndryshme nga inkasimi i biletave	Tarifa	30%
7.3	Qëllimet rekreative pa ndryshime nga inkasimi i biletave	Tarifa	30%
7.4	Qëllimet rekreative pa ndriçim për një orë	Tarifa	10.00€
7.5	Qëllimet rekreative me ndriçim për një orë	Tarifa	15.00€
7.6	Për fushatë të partive politike për një orë	Tarifa	100.00€
7.7	Për shfrytëzimin e palestës nga organizatat e ndryshme per koncerte apo shfaqje të ndryshme për një orë		30%

## E drejta e reklamimit

**Subjektet e interesuara ju mundësohet vendosja e reklamave të tyre me këto dimensione dhe me tarifa mujore:**

- 1.Në qendrën e fushës së futbollit,hendbollit,basketbollit –fucall në parket --- 150.00€
- 2.Në gjysëmrrrethin e reketit të fushës së basketbollit –futcallit ----- 50.00€
- 3.Në hapsirën e (7)shtatë metërshit të fushës së futcallit : 2x0.60m-----50.00€
- 4.Në hapsirën mbrenda fushës së basketbollit dhe hendbollit: 2x0.60m----- 50.00€
- 5.Rreth vijave të fushës së basketbollit dhe hendbollit: 3x60m -----40.00€
- 6.Në pjesën ansore (veriore dhe jugore,në muri)të palestrës 3x0.60m-----40.00€
- 7.Në pjesën tjetër të palestrës dimenzioni 2x.60m-----20.00€
- 8.Kohëzgjatja e vendosjes së reklamës në vendet e zgjedhura do të jetë deri në një vitë me të drejtë vazhdimi sipas kontratës së re.
- 9.Vendi ivendosjes së reklamës caktohet me rastin e nënshkrimit të marrëveshjes .
- 10.Shpenzimet e shkrimit,vendosjes dhe zhvendosjes së reklamës i bartë subjekti i cili ka vendosur reklamën.
- 11.Pagesa për reklamën e ekspozuar bëhet çdo muaj dhe atë në fillim nga data 1-5 të muajit vijues .

## Tarifat ne shtëpin e kulturës

- 1.Asamblet ,trupat teatrale,OJQ-të që ushtrojnë veprimtari kulturore ,që janë të regjistruara në DKRS,janë të liruara nga pagesa në shfrytëzimin e sallës.
- 2.Për aktivitete politike(fushata zgjedhore,tubime,organizime me karakter politik)
  - 2.1 Për 1 orë -----100.00€
  - 2.2 Për 2 orë-----150.00€
  - 2.3Për më tepër se dy orë-----200.00€
  - 2.4 Për tërë ditën -----400.00€
3. **Nga shfrytëzimi i sallës dhe hapsirës së arteve**
  - 3.1 Për ngjarje komerciale (ekspozita,revy dhe të ngjajshme )-----100.00€
  - 3.2 Për ngjarje humanitare ----- ( gratis )
  - 3.3Për koncerte të ndryshme 30% nga inkasimi i mjeteve prej biletave ose pages fikse sipas marrëveshjes.
4. **Të hyrat nga antarësimi i lexuesve :**
  - 4.1 Antarësimi për fëmijë(klasae I-IX) për një vit -----5.00€
  - 4.2 Antarësimi për të rritur për një vit -----10.00€
  - 4.3 Në rastë të humbjes apo thyerjes së librezës duhet të nxirret librezja e re duke paguar 50% të çmimit kushtue të librezës origjinale.
5. **Lirimi nga pagesa**
  - 5.1 Antarët e ngushtë të familjeve të dëshmorëve;
  - 5.2 Invalidët dhe veteranëtë luftës së UÇK-së(familja e ngushtë);
  - 5.3 Përsonat me nevoja të veçanta;
  - 5.4 Përsonat me asistencë sociale ;

- 5.5 Parashkollorët, fëmijët bonjak (të braktisur) dhe pensionistët;
- 5.6 Lexuesit e degëve të bibliotekës në fshatra;
- 5.7 Anëtarësimi në datat kalendarike ndërkombëtare të librit ;
- 5.8 Dhuruesit e gjakut;
- 5.9 Punonjësit e bibliotekës

### Neni 31

#### **Tarifat për financimin e programeve të veçanta të banimit, sipas ligjit Nr.03/L-164 neni. 9**

Për financimin e programeve të veçanta të banimit, Kuvendi Komunal për çdo vit aprovon shumën e qiras vjetore, për banesat me qira e cila përcaktohet sipas formulës: qiraja jo profitabile mujore është e barabart me vlerën e banesës herë 4%, pjesëtuar me 12 muaj.

$$\text{Qiraja jo profitabile mujore} = \text{vlera e banesës} \times 0.04\%$$

---

12 muaj

$$\text{Qjm} = \text{vb} \times 0.04$$

---

12

**Tarifa e qiras mujore për m<sup>2</sup> në vitin 2023 është 1.40€**

#### **2. Taksa komuna për shfrytëzimin afatgjatë të sipërfaqes së tokës së pandërtuar pronë komunale paguajnë taksën komunal vjetore të shfrytëzimit, si në vijim:**

- 2.1. Shfrytëzimi i tokës për kultivimin e kulturave bujqësore caktohet tarifa vjetore – njëqindë euro për hektar (100.00€/ha);
- 2.2. Qiraja e sipërfaqes së tokës për ngritjen e objekteve për qellime komerciale, zyra, lokale etj.. në zonën e parë në vend të frekuentuar caktohet tarifa mujore në sipërfaqe të tokës për m<sup>2</sup> - një euro për një metër në katror (1.00€/m<sup>2</sup>);
- 2.3. Sipërfaqe e tokës së pa ndërtuar në Zonën I – pesë cent për një metër në katror (0.05€/m<sup>2</sup>); vjetore
- 2.4. Sipërfaqe e tokës së pa ndërtuar në Zonën II – katër cent për një metër në katror (0.04€/m<sup>2</sup>); vjetore
- 2.5. Sipërfaqe e tokës së pa ndërtuar në Zonën III – tre cent për një metër në katror (0.03€/m<sup>2</sup>); vjetore
- 2.6. Sipërfaqe e tokës së pa ndërtuar në Zonën IV – dy cent për një metër në katror (0.02€/m<sup>2</sup>); vjetore

### 3. Taksa komuna (Qiraja) për shfrytëzimin afatëshkurtë të Zyrave dhe lokaleve afariste pronë komunale

- 3.1 Objektet (Zyra) në pronë komunale –tarifa mujore –zona e parë –I- -----4.00€m<sup>2</sup>  
 3.2 Objektet (Zyra) në pronë komunale-tarifa mujore -zona e dytë,tretë dhe katërt -II-III,dhe IV-2.00€m<sup>2</sup>  
 3.3 Lokalet afariste në pronë të komunës –tarifa mujore zona e parë –I-----4.00€m<sup>2</sup>  
 3.4 Lokalet afariste në pronë komunale-tarifa mujore-zona e parë,dytë,tretë dhe katërt--II-III-IV- 2.00€m<sup>2</sup>

4. Taksa komuna (Qiraja) për shfrytëzimin afatëshkurtë të Zyrave dhe lokaleve afariste pronë komunale, bëhet deri më datën pesë (5) të muajit vijues, pas shfrytëzimit, kurse pagesa e taksës komunale për shfrytëzimin afatgjatë të sipërfaqes së tokës së pandërtuar pronë komunale sipas afati kohor rregullohet me Kontratën e nënshkruar nga Operatori ekonomik me aktvendim.

#### Neni 32

#### Taksa komunale për qëndrim në institucionet parashkollore

1.1 Tarifa mujore për qëndrim në qerdhe	
a) Tarifa për fëmijun e parë .....	40.00 €
b) Tarifa për fëmijun e dytë .....	28.00 €
c) Tarifa për fëmijun gjysëm ditorë .....	20.00 €
1.2 Duplikati i dëftesave ,diplomave në arsim	
a) Duplikati i diplomave .....	1.00 €
b) Duplikati i dëftesave .....	1.00 €
c) Vertetime të ndryshme .....	1.00 €
1.3 Vijuesit e shkollave të mesme të larta profesionale , duhet të participojnë për mbajtjen e mësimit teorik dhe praktik (shkollimi i mesëm)	
a) Për regjistrimin e vitit (për një klasë).....	100.00 €
b) Për praktikë profesionale .....	50.00 €
c) Provimi diferencial.....	10.00 €
d) Për riprovim nxënësi paguan.....	5.00 €
e) Për provimet përfundimtare të klasës,çertifikatë-diplomë.....	50.00 €

Për qëndrim të plotës ditor - dyzetë euro (40 €);

Për fëmijun e dyt të familjës së njëjt – njëzetë e tetë euro (28 €);

Për fëmijun e tretë të familjës së njëjt – njëzetë euro (20 €);

2. Pagesa e taksës për qëndrim në institucionet parashkollore paguhet deri në datën 5 të muajit në të cilin realizohet qëndrimi.

#### Neni 33

#### Taksa komunale për kullosa

1. Taksat për shërbimet profesionale për prerje të pyjeve private:

-Dru zjarri për m<sup>3</sup> në shumë prej 1,50€

-Dru zjarri mbi 7 m<sup>3</sup> në shumë prej 2,00€

-Dru teknik për m<sup>3</sup> në shumë prej 3.00€

## 2.Lartësia e taksës për shfrytëzimin e kullosave

Lloji i bagëtisë	NB/kokë	EUR/kokë
Gjedhët mbi një vjet	1	1.20
Viçat	0.45	0.54
Delet	0.18	0.22
Qengjat	0.1	0.12
Kuajtë dhe gomarët	1	1.20
Dosat	0.5	0.60
Derrat	0.3	0.36
Rosat	0.014	0.02

2.Pagesa sipas paragrafit një dhe dy të këtij neni bëhet deri në tridhjetë e një (31) dhjetor të vitit aktual.

### Neni 34

#### Taksa komunale për qëndrimin e veturave përjashtuara nga komunikacioni nëparkingun e Komunës

1. Çdo person, të cilit i qëndron vetura në parkingun e komunës si pasojë e përjashtimit nga komunikacioni, paguan taksë si në vijim:

- 1.1. Automjetet, motoçikletë dhe traktor – një euro e gjysmë (1.5 €) për një ditë;
- 1.2. Mjetet tjera deri në tre tonë e gjysmë (3.5 t) - tre euro (3 €) për një ditë; dhe
- 1.3. Mjetet mbi tre tonë e gjysmë (3.5 t) - pesë euro (5 €) për një ditë;

2. Lartësia e taksës së përcaktuar në paragrafin 1 të këtij neni zbatohet pesëdhjetë për qind (50 %), pas kalimit të nëntëdhjetë (90) ditëve të qëndrimit të veturës në parkingun e komunës.

3. Pagesa e taksës së përcaktuar në paragrafin një (1) të këtij neni bëhet para marrjes së veturës nga parkingu i Komunës dhe vetura nuk mund merret pa pagesën e taksës.

### Neni 35

#### Taksa komunale për bllokimin e rrugëve sekondare

1. Çdo person i cili pas marrjes së lejes përkatëse bën bllokimin e rrugëve sekondare të Komunës, paguan taksat si në vijim:

- 1.1. Bllokimi i rrugës sekondare nga personat fizik deri në gjashtë (6) orë – pesë euro (5 €);
- 1.2. Bllokimi i rrugës sekondare nga personat fizik nga gjashtë (6) deri në dymbëdhjetë (12) orë – dhjetë euro (10 €);
- 1.3. Bllokimi i rrugës sekondare nga personat fizik nga dymbëdhjetë (12) deri në njëzet e katër (24) orë – njëzetë euro (20 €);
- 1.4. Bllokimi i rrugës sekondare nga personat fizik mbi njëzet e katër (24) orë – njëzetë euro (20 €) për çdo ditë;
- 1.5. Bllokimi i rrugës sekondare nga personat juridik deri në gjashtë (6) orë –

pesëmbëdhjetë euro (15 €);

1.6. Bllokimi i rrugës sekondare nga personat juridik nga gjashtë (6) deri në dymbëdhjetë (12) orë – tridhjetë euro (30 €);

1.7. Bllokimi i rrugës sekondare nga personat juridik nga dymbëdhjetë (12) deri në njëzet e katër (24) orë – pesëdhjetë euro (50 €);

1.8. Bllokimi i rrugës sekondare nga personat juridik mbi njëzet e katër (24) orë - pesëdhjetë euro (50 €) për çdo ditë;

2. Çdo person i cili pas marrjes së lejes përkatëse bën bllokimin e pjesshëm të rrugëve sekondare të Komunës për qëllim të ndërtimit, paguan taksat ditore në vlerë prej dhjetë euro (10€).

3. Paguesa e taksës sipas paragrafit një (1) dhe dy (2) të këtij neni paguhet para bllokimit të rrugës sekondare.

### **Neni 36**

#### **Lirimet nga taksa komunale për shfrytëzimin e objekteve, hapësirës dhe të mirave publike**

1. Nga taksa komunale për shfrytëzimin e objekteve, hapësirave dhe të mirave publike janë të liruara kategoritë si në vijim, në rastet kur veprimtarie për shfrytëzimin e objekteve, hapësirës dhe të mirave publike të Komunës ndërlidhet me statusin e tyre personal apo me ushtrimin e veprimtarisë afariste në cilësinë e pronarit të biznesit individual:

1.1. Veteranët e luftës;

1.2. Invalidët e luftës së UÇK-së dhe familjarët e dëshmorëve dhe të zhdukurve të UÇK-së; dhe

1.3. Personat e verbër.

## **KAPITULLI IX**

### **GJOBAT LIDHUR ME TAKSAT KOMUNALE**

#### **Neni 37**

#### **Gjobat lidhur me mos paraqitjen e lindjes dhe vdekjes**

1. Çdo preson fizik përgjegjës i cili nuk paraqet lindjen e fëmijës në territorin e Komunës në afatin prej tridhjetë (30) ditësh nga data e lindjes kryen kundërvajtje të lehtë dhe nga Komuna i shqiptohet gjobë në vlerë prej pesëdhjetë euro (50 €).

2. Çdo person fizik përgjegjës i cili nuk e lajmëron vdekjen pësonit të regjistruar me vendbanim në Komunë brenda tridhjetë (30) ditëve nga data e vdekjes së personit brenda Republikës së Kosovës, apo brenda gjashtë (60) ditëve për vdekjet e ndodhura jashtë Republikës së Kosovës, kryen kundërvajtje të lehtë dhe nga Komuna i shqiptohet gjobë në vlerë prej tetëdhjetë euro (80 €).

3. Çdo drejtues i spitalit, burgu, institucionit të riedukimit dhe institucioneve tjera përkatëse, i cili nuk e lajmëron vdekjen e personit të regjistruar me vendbanim në Komunë brenda (5) ditëve nga data e vdekjes së ndodhur në institucionet e tyre, kryen kundërvajtje të lehtë dhe Komuna i shqipton gjobë prej shtatëdhjetë euro (70 €).

### **Neni 38**

#### **Gjobat lidhur me vendbanimin dhe vendqëndrimin**

1. Çdo person fizik që ka vendbanim apo vendqëndrim në Komunë dhe i cili nuk i ndërmarr verimet e paraparë në këtë paragraf, kryen kundërvajtje të lehtë dhe Komuna i shqipton gjobë në vlerë prej tetëdhjetë (80 €):

1.1. nuk e lajmëron ndryshimin vendbanimin dhe vendqëndrimin brenda territorit të komunës, brenda tetë (8) ditëve nga ky ndryshim;

1.2. nuk e lajmëron largimin nga Republika Kosova, me qëllim të qëndrimit për më shumë se gjashtëdhjetë (60) ditë; dhe

1.3. nuk e lajmëron kthimin në Republikën e Kosovë, me qëllim të qëndrimit për më shumë se gjashtëdhjetë (60) ditë.

### **Neni 39**

#### **Gjobat lidhur me mos pagesën e taksës për ushtrimin e veprimtarisë afariste**

1. Çdo shoqëri tregtare që vepron si biznes individual, i cili nuk e paguan taksën vjetore në emër të ushtrimit të veprimtarisë afariste brenda afatit të përcaktuar me këtë Rregullore, kryen kundërvajtje të lehtë dhe Komuna i shqipton gjobë në vlerë prej pesëdhjetë euro (50 €).

2. Çdo shoqëri tregtare që nuk vepron si biznes individual, i cili nuk e paguan taksën vjetore në emër të ushtrimit të veprimtarisë afariste përcaktuar me këtë Rregullore, kryen kundërvajtje të lehtë dhe Komuna i shqipton gjobë në vlerë prej njëqind euro (100 €).

### **Neni 40**

#### **Gjobat lidhur mos pagesën e taksës komunale mbi mjetet motorike**

1. Çdo person fizik i cili nuk e paguan taksën komunale për mjetin motorik brenda afatit të përcaktuar në këtë Rregullohet, kryen kundërvajtje të lehtë dhe Komuna i shqipton gjobë në vlerë prej dhjetë euro (20 €).

2. Çdo shoqëri tregtare që vepron si biznes individual, e cila nuk e paguan taksën vetore për mjetin motorik brenda afatit të përcaktuar në këtë Rregullohet, kryen kundërvajtje të lehtë dhe Komuna i shqipton gjobë në vlerë prej tridhjetë (40 €) euro.

3. Çdo shoqëri tregtare apo person tjetër juridik i cili nuk vepron si biznes individual, që nuk e paguan taksën vetore për mjetin motorik brenda afatit të përcaktuar në këtë Rregullohet, kryen kundërvajtje të lehtë dhe Komuna i shqipton gjobë në vlerë prej njëqind euro (100 €).

#### **Neni 41**

##### **Gjobat për mos pagesën e taksës komunale për ndërhyrje në infrastrukturë komunale dhe taksës komunale për rrënim të objekteve pa leje**

1. Çdo person i cili nuk e paguan taksën komunale për ndërhyrje në infrastrukturë komunale dhe taksës komunale për rrënim të objekteve pa leje sipas afatit të përcaktuar në këtë Rregullore, kryen kundërvajtje të lehtë dhe Komuna i shqipton gjobë si në vijim:

1.1. për personin fizik – njëqind euro (100 €);

1.2. për personi fizik që ushtron biznes individual – dyqind euro (200 €); dhe për personin juridik – treqind euro (300 €)

#### **Neni 42**

##### **Gjobat lidhur me mos pagesën e taksës komunale për vendosjen e panove reklamuese**

1. Çdo shoqëri i cili nuk paguan takës komunale mbi vendosjen e panove reklamuese e cila kalon vlerën prej njëqind euro (100 €) sipas afateve të përcaktuar nga kjo Rregullore kryen kundërvajtje të lehtë dhe Komuna i shqipton gjobë si në vijim:

Shoqëritë tregtare të regjistruara si biznes individual – pesëdhjetë euro (50 €); dhe

Shoqëritë tregtare tjera – njëqind euro (100 €) euro

#### **Neni 43**

##### **Gjobat lidhur taksa komunale për vendosjen e objekteve të në hapësirat publike**

1. Çdo person i cili nuk e paguan taksën komunale për vendosjen e objekteve të ndryshme në hapësirën publike sipas dispozitave të kësaj Rregulloreje, e cila kalon vlerën mbi njëqind euro (100 €), kryen kundërvajtje të lehtë dhe Komuna i shqipton gjobë si në vijim:

Individët dhe shoqëritë tregtare të regjistruara si biznes individual – pesëdhjetë euro (50 €); dhe Shoqëritë tregtare tjera – njëqind euro (100€).

#### **Neni 44**

##### **Gjobat për mos pagesës e taksës komunale për bllokimin e rrugëve sekondare**

1. Çdo person i cili nuk e paguan taksën komunale për bllokimin e rrugëve sekondare sipas dispozitave të kësaj Rregulloreje kryen kundërvajtje të lehtë dhe Komuna i shqipton gjobë si në vijim:

1.1 Personat fizik dhe shoqëritë tregtare të regjistruara si biznes individual-tridhjetë euro (30 €);

1.2. Personat juridik – njëqind euro (100 €)

#### **Neni 45**

##### **Gjobat mbi mos pagesën e taksës komunale për mbajtjen e kafshëve shtëpiake dhe taksën komunale mbi kullosat**

1. Çdo person i cili nuk e paguan taksën mbi mbajtjen e kafshëve shtëpiake dhe taksën komunale mbi kullosat sipas afatit të përcaktuar me këtë Rregullore konsiderohet se ka kryer kundërvajtje të lehtë dhe Komuna i shqipton gjobë si në vijim:
  - 1.1. Për personin fizik – njëzetë euro (20 €); dhe
  - 1.2. Për personin juridik – njëqind euro (100€).

#### **Neni 46**

##### **Pagesat e gjobave dhe çështjet tjera mandatorë**

1. Gjobat të përcaktuara me këtë Rregullore paguhen brenda tridhjetë (30) ditëve nga data e shqiptimit të tyre.
2. Në rast të pagimit të gjobës së shqiptuar me këtë Rregullore brenda afatit pesëmbëdhjetë (15) ditësh, i dënuari lirohet nga pagimi i pesëdhjetë përqind (50%) të shumës së gjobës së shqiptuar.
3. Presoni ndaj të cilit shqiptohet gjobë sipas dispozitave të kësaj Rregulloreje ka të drejtën e ankesës, sipas afateve dhe procedurave të parapara në legjislacionin në fuqi për procedurën e përgjithshme administrative.
4. Procedurat kundërvajtëse zhvillohen nga Komuna në përputhje me legjislacionin në fuqi për kundërvajtjet.

### **KAPITULLI XI DISPOZITAT KALIMTARE DHE PËRFUNDIMTARE**

#### **Neni 47**

##### **Taksat Qendrore**

1. Me qëllim të zbatimit të legjislacionit në fuqi të miratuar nga Kuvendi i Republikës së Kosovës dhe Qeverisë së Republikës së Kosovës, Komuna ofron shërbime të ndryshme të deleguar nga niveli qendror dhe mbledh taksë të përcaktuar nga ky nivel, si në vijim.
- 3.5 Taksat për shërbimet kadastrale sipas Udhëzimit Administrativ (MMPH) Nr.11/2019 për ndarjen e ndërtesës dhe të pjesës së ndërtesës.
- 3.6 Udhëzimit Administrativ MMPH Nr.12/2019 për Ndarjen dhe Regjistrimin e Parcelave .
- 3.7 Udhëzimit Administrativ (MEA) Nr.09/2020 për Tarifat e Shërbimeve për Regjistrimin e të Drejtave të Pronës së Paluajtshme.
- 3.8 Udhëzimit Administrativ (MMPHI) Nr.05/2021 për ndryshimin dhe plotësimin e udhëzimit administrativ(MEA) Nr.09/2020 Për tarifat e shërbimeve për regjistrimin e të drejtave të pronës së paluajtshme .
- 4 Taksa për dhënien e lejes mjedisore të përcaktuara sipas Udhëzimit Administrativ MMPH Nr. 01/2017 për Dhënien e Lejes Komunale Mjedisore, apo çdo legjislacioni pasues;
- 5 Taksa për shërbimet shëndetësore të përcaktuara sipas Udhëzimit Administrativ Nr. 04/2007 – dhe Udhëzimi Administrativ (Shëndetësi) Nr.04/2013, Mbledhja dhe Shfrytëzimi i Mjeteve nga Bashkë Pagesat e Shfrytëzuesve të Shërbimeve Shëndetësore dhe të Hyrave Vetanake të Institucioneve Shëndetësore apo çdo legjislacioni pasues;
- 6 Taksa për qasje në dokumente publike të përcaktuara sipas Rregullores Nr. 02/2012/MF për Tarifat në Qasje në Dokumente Publike, apo çdo legjislacioni pasues;

- 7 Taksa për vijim dhe përfundim të arsimit dhe aftësimin për të rritur të përcaktuara sipas Udhëzimit Administrativ Nr. 11/2011 për Participim të Vijuesve të Arsimit dhe Aftësimin për të rritur, apo çdo legjislacion pasues; Rregullorja e Ministrisë së arsimit 01/17.për planifikimin e të hyrave vetanake dhe sipas Rregullores së shkollës nr.1164/2 të dt.20/10/2017;
- 8 Taksa për shërbimet e ofruara për regjistrim të bizneseve, të përcaktuara sipas Udhëzimit Administrativ (MINT) Nr. 12/2022 për Përcaktimin de Taksave për Shërbimet e Ofruara nga Agjencia për Regjistrimin e Bizneseve, apo çdo legjislacion pasues; dhe
- 9 Taksa për lëshimin e dokumentacion arsimor duplikatë, të përcaktuar sipas Udhëzimit Administrativ 03/2013 – Lëshimi i Dokumenteve Duplikatë nga Institucionet Edukativo – Arsimore dhe Universitare, apo çdo legjislacion pasues.
- 10 Çdo akt normativ tjetër i Qeverisë së Republikës së Kosovës apo ndonjë agjencie të pavarur që miratohet pas hyrjes në fuqi të kësaj Rregulloreje që parasheh taksa qendrore, zbatohet nga Komuna, pa pasur nevojë që kjo Rregullore të ndryshojë

#### **Neni 48 Shtojcat**

1. Në shtojcën e kësaj Rregulloreje janë të bashkëngjitura:

Shtojca Nr. 1

Ku janë listuar në formë tabelare të gjitha taksat komunale të përcaktuara sipas dispozitave të kësaj Rregulloreje; dhe

Shtojca Nr. 2

Ku janë listuar në formë tabelare të gjitha taksat qendrore të përcaktuara nga Qeveria e Republikës së Kosovës.

#### **Neni 49**

#### **Transparenca në taksat komunale**

1. Nëpërmjet kësaj Rregulloreje autorizohet Kryetari i Komunës që, përmes drejtorisë përkatëse për administratë, të përditësojë Shtojcën Nr. 2 të kësaj Rregulloreje me një vendim dhe të publikojë, kurdo që Qeveria e Republikës së Kosovës apo ndonjë agjenci e pavarur ndryshon taksat ekzistuese qendrore apo përcakton ndonjë taksë tjetër.

2. Për vendimin e marrë sipas paragrafit 1 të këtij neni, Kryetari i Komunës njofton Kuvendin Komunal dhe ky vendim zëvendëson Shtojcën Nr. 2 të përcaktuar sipas kësaj Rregulloreje apo të ndryshuar me vendimin paraprak të Kryetarit të Komunës.

#### **Neni 50 Shfuqizimi**

Me hyrjen në fuqi të kësaj Rregulloreje shfuqizohet Rregullorja për tarifa, ngarkesa dhe gjopa komunale me nr.-I-94/29.06.2018).

#### **Neni 51 Publikimi**

Republikës së Kosovës. Kjo Rregullore publikohet në ueb faqen elektronike të Komunës dhe të Gazetës Zyrtare të


#### **Neni 52 Hyrja në fuqi**

Kjo Rregullore hynë në fuqi pesëmbëdhjete (15) dite pas regjistrimit në zyrën e protokollit të Ministrisë së Administrimit të Pushtetit Lokal, si dhe shtatë (7) ditë pas publikimit në ueb- faqen zyrtare të Komunës së Obiliqit.

## KUVENDI I KOMUNËS SË OBILIQIT

Obiliq 30.06 2023

Kryesuese e Kuvendit Komunal

  
Vlora Mjekiqi Kabashi



Pjesë përbërse e kësaj rregulloreje është **Shtojca 1 dhe shtojca 2 Taksat Qëndrore**

**Shtojca Nr. 1**  
**TAKSAT KOMUNALE**

**Tabela Nr. 1 – Taksat komunale për lëshimin e certifikatave dhe dokumenteve zyrt**

Nr.	Kategoria	Taksa
1.	Certifikata e lindjes	1 €
2.	Ekstrakti i lindjes	1 €
3.	Certifikata e shtetësisë	1 €
4.	Certifikata e martesës	1 €
5.	Certifikata e vendbanimit apo e vendqëndrimit	1 €
6.	Certifikata e gjendjes martesore	1 €
7.	Certifikata e vdekjes	1 €
8.	Certifikata e bashkësisë familjare	1 €
9.	Akti i vdekjes	1 €
10.	Vërtetim për afërsinë familjare	1 €
11.	Vërtetim mbi mjetet e jetesës	1 €
12.	Vërtetim për mbajtjen e prindërve	1 €
13.	Vërtetim mbi marrëdhëniet familjare	1 €
14.	Vërtetim që personi është në jetë	1 €
15.	Vërtetim që personi nuk është banor i komunës	1 €
16.	Vërtetimi mbi konfirmimin e identitetit	1 €
17.	Vërtetim për lajmërim apo ç'lajmërimin e vendbanimit	1 €
18.	Vërtetimi që personi nuk është regjistruar në regjistrat civil	1 €
19.	Vërtetimi që personi nuk është në marrëdhënie pune	1 €
20.	Vërtetimi për gjendjen ekonomike	1 €
21.	Kopja e certifikatave dhe vërtetimeve të lëshuara më parë	0.50 €
22.	Procedurat për trashëgimi	5 €
23.	Dhënja e çdo lloji të certifikatës në bazëtë dy dëshmitarëve	2€
24.	Vërtetimi për qëndrim të përkohshëm në Kosovë	5€
25.	Certifikata mbi gjendjen ekonomike ,deklarata apo vërtetime tjera	3€
26.	Ndrrimi dhe korrigjimi i emrit personal	5€
27.	Regjistrimi nga bota e jashtme	5€
28.	Regjistrimet e mëvonëshme përmes bordit	5€
<p><b>Shënim:</b> Veteranët e luftës, invalidët e luftës së UÇK-së dhe familjarët e dëshmorëve dhe të zhdukurve të UÇK-së, personat e verbër; personat paraplegjik dhe tetraplegjik dhe përfutuesit e skemave sociale janë të liruar nga kjo pagesë.</p>		

**Tabela Nr. 2 – Taksat komunale administrative**

<b>Nr.</b>	<b>Kategoria</b>	<b>Taksa</b>
1.	Kurorëzimi brenda objektit të komunës, brenda orarit të punës	10 €
2.	Kurorëzimi brenda objektit të komunës, jashtë orarit të punës	20 €
3.	Kurorëzimi jashtë objektit të komunës, brenda orarit të punës	50 €
4.	Kurorëzimi jashtë objektit të komunës, jashtë orarit të punës	100 €
5.	Korrigjimi emrit personal (germëzimi)	3 €
6.	Korrigjimi i emrit personal	5 €
7.	Ndërrimi i mbiemrit pas anulimit të martesës	5 €
8.	Ndërrimi i emrit personal	20€
9.	Anulimi i dyfishtë i regjistrimit në gjendjen civile	5 €
10.	Konfirmimi i deklaratës me dy dëshmitar	2 €
11.	Kërkesa për procesverbal të ndryshme	5 €
12.	Pajisja me dokumente nga arkiva (për një faqe)	0.20 €
13.	Lëshimi i vërtetimit për gjendjen e tatimit në pronë	1 €
14.	Konfirmimi i vërtetësisë së nënshkrimit	1 €
15.	Konfirmimi i vërtetësisë së fotokopjes (për një faqe A4)	0.15 €
16.	Konfirmimi i vërtetësisë së fotokopjes (për një faqe A3)	0.25 €
17.	Leja mbi varrimin	3 €
18.	Inspektime të ndryshme me kërkesën të personave fizik	10 €
19.	Inspektime të ndryshme me kërkesë të personave juridik	15 €
20.	Asgjësim mallrash me kërkesë për mallrat ushqimore	60€
21.	Asgjësim mallrash me kërkesë për mallrat jo ushqimore	30€
22.	Lëshimi i certifikatës së përdorimit	20 €
23.	Lëshimi i pëlqimit urbanistik dhe dokumenteve tjera urbanistike	10 €
24.	Lëshimit të pëlqimeve dhe dokumenteve tjera në fushën emergjencës	15 €
25.	Lëshimi i pëlqimeve dhe dokumenteve tjera në fushën e higjienës dhe Saniratisë	15 €
26.	Lëshimi i pëlqimeve dhe dokumenteve tjera në fushën e tregtisë	15€

